

# HELSINKI COMMITTEE FOR HUMAN RIGHTS



ЧЛЕН НА ХЕЛСИНШКАТА ФЕДЕРАЦИЈА НА ЧОВЕКОВИ ПРАВА

**Statut konsultativ ndaj Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Europës**

E-mail: [helkom@mhc.org.mk](mailto:helkom@mhc.org.mk); Web: <http://www.mhc.org.mk>

## **RAPORT I KOMITETIT TË HELSINKIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË REPUBLIKËN E MAqedonisë LIDHUR ME GJENDJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË VITIN 2002**

Viti 2002 për Republikën e Maqedonisë ishte vit në të cilin shteti duhej t'i sanojë pasojat themelore të konfliktit të vitit 2001; ta implementojë Marrëveshjen kornizë të Ohrit (si garancë për paqë) dhe ta mundësojë realizimin e zgjedhjeve të parakohshme. Periudha që pason pas konfliktit karakterizohet me përpëlitje të mëdha politike (krijimi i partive të reja politike dhe ndryshimet në relacion të forcave), si dhe me korrupsion më të madh të strukturave politike, partizim të madh të aparatit shtetëror dhe pamundësi të të kontaktuarit me struktura më të larta politike. Aktivitetet parazgjedhore dhe periudha e ndërrimit të qeverisë i theksojnë të gjitha këto situata. Karakteristika themelore e situatës së përgjithshme politike është rritja e dhunës dhe pasiguria e banorëve (për shkak të veprimit të kufizuar të policisë, prezencës së grupeve të armatosura dhe individëve të armatosur që veprojnë në pjesë të caktuara të shtetit, pastaj, veprimit të pjesëve të pakontrolluara të policisë, mosfunksionimit të organeve juridike, krimeve ende të pazgjidhura dhe manipulimit me marrëdhëniet ndëretnike, keqësimit të standardit, papunësisë, zvogëlimit të mbrojtjes sociale). Veprimet fillestare të strukturës së re udhëheqëse tregojnë se partizimi i aparatit shtetëror do ta karakterizojë edhe periudhën e ardhëshme.

Situata e këtillë politike lejon mosrespekt, lëndim dhe mungesë të mbrojtjes adekuate të të drejtave dhe lirive të njeriut në të gjitha sferat e jetës së përditshme. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut mbeten në nivel të deklaratës dhe parullës politike. Në shumë sfera gjendja merr përmasa alarmante dhe kanoset me eskalim të mëtutjeshëm, gjë që mund të ndodhë nëse shteti nuk nis t'i realizojë obligimet e veta dhe nëse nuk pranon të veprojë në drejtim të përmirimit të përgjithshëm të gjendjes, që duhet kuptuar si detyrë primare.

**Gjatë vitit 2002 Komiteti i Helsinkit u kushtoi vëmendje të posaçme disa fushëveprimeve që kanë të bëjnë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat gjatë këtij viti u treguan si më të rëndësishme, gjegjësisht, të cilat ishin sfera ku më së tepërmi u lënduan të drejtat e njeriut.**

## 1. Zgjedhjet

Përkundër përcaktimit të Marrëveshjes kornizë të Ohrit me të cilën parashikohej mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 27 janar të vitit 2002, për shkak të kundërvënies midis partive kryesuese politike (VMRO-DPMNE dhe PDSH) u mbajtën zgjedhje të rregullta, më 15 shtator të vitit 2002. Vëzhguesit e jashtëm (përfaqësues të OBSE-së, Këshillit të Europës dhe Unionit të Europës, si dhe një numër i caktuar i organizatave joqeveritare ndërkombëtare), duke përfshirë këtu edhe vëzhguesit nga vendi (Organizata joqeveritare të Republikës së Maqedonisë) zgjedhjet i vlerësuan si të drejta dhe demokratike. Rezultati i fituar gjatë zgjedhjeve në masë të madhe përkon me parashikimet që i dhanë timet e pavarura hulumtuese gjatë periudhës parazgjedhore.

Komiteti i Helsinkit përgatiti raport të përmbledhur, mes tjerash edhe në funksion të përsosjes së mëtutjeshme të sistemit zgjedhor dhe të mundësive të realizimit të tërësishëm të të drejtës për zgjedhje.

Në periudhën parazgjedhore Komiteti regjistroi disa thyerje që mund të kenë pasur ndikim në procesin zgjedhor: indikacionet lidhur me falsifikimin e fletave votuese dhe përdorimi i metodës së “trenit bullgar” në falsifikimin e zgjedhjeve; përpjekja për t’i zgjeruar listat zgjedhore duke u dhënë nënshtrësi Maqedonasëve etnik që jetojnë në shtetet fqinje dhe në diasporë; aktivitetet e anëtarëve të Ministrisë së punëve të brendshme drejtuar kah frikësimi i kundërshtarëve politikë dhe krijimi i atmosferës së pasigurtë; mosrespektimi i Ligjit për zgjedhjen e deputetëve (në nenin 7) nga ana e ministrit të punëve të brendshme dhe zëvendësit të tij; korruptimi i votuesve dhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes në shprehjet e kandidatëve të partive të ndryshme. Heshtja parazgjedhore u thye ashpër në më shumë vende të shtetit me shpërndarjen e fletushkave (me brendi fyese) dhe nga ana e disa medimeve elektronike (MTV i shtetit dhe më shumë stacione lokale). Mediumet shtetërore (MRTV, Nova Makedonija, Veçer dhe mediumi privat Sitel) botuan një sërë përmbajtjesh anti-përendimore, e sektorin joqeveritar e shpallën si “kolonë të pestë”.

Në ditën e votimit u evidentua presion (i hapur dhe i fshehur) nga ana e më shumë partive politike; në më shumë vende nuk u sigurua mundësia e votimit sekret (për shkak të vendvotimeve joadekuate dhe vendosjes joadekuate të tavolinave votuese), nuk u mundësua qasja e personave të hendikepuar; nuk u respektua ndalimi i mbajtjes së armëve nëpër vendvotime. Komiteti e vërejtë dobësinë e “vulosjes moderne”, stërpikjen e gishtit të madh si dëshmi e votimit të kryer, si dhe përbërjen, trajnimin dhe neutralitetin e këshillave zgjedhor.

Në bashkësinë shqiptare ende është prezent votimi kolektiv dhe jopavarësia gjatë votimit të grave (edhe përkundër evidencës së lëvizjeve pozitive në këtë drejtim). Posaçërisht i përhapur është “votimi bashkëshortor” (prezent edhe tek bashkësitë tjera), gjë që këshillat zgjedhorë nuk e trajtojnë me seriozitet të mjaftueshëm.

Njëra prej vërejtjeve themelore që mund t’i drejtohet Komisionit zgjedhor të shtetit (që në tërësi iu përgjegj obligimeve të veta dhe ishte në nivel të lartë gjatë kryerjes së detyrave të veta) është mungesa e fleksibilitetit më të madh dhe përgatitjes për të reaguar hë për hë kur ndodhin incidente dhe kur thyen të drejtat votuese.

Në periudhën që pasoi pas zgjedhjeve u vërejt përpjekje presioni dhe ndikimi ndaj Komisionit zgjedhor të shtetit. Ministria e punëve të brendshme (në

krye me ministrin) i lejoi vetes të hyjë pa leje në vendet e Komisionit. As kjo e as thyerjet tjera më të vogla të Ligjit nuk shërbyen si bazë për të nisur procedura penale.

Opinionit publik nuk u njohtua me raportin e Komisionit zgjedhor, që ky duhej t'ia jep Këshillit, me ç'rast mungoi informata e tërësishme lidhur me vijimin e zgjedhjeve, pastaj, lidhur me problemet që u hasën dhe me aktivitetet që u ndërmorrën për t'i tejkaluar këto probleme, gjegjësisht, lidhur me padimin e thyersëve të të drejtës. Opinionit publik nuk u informua as për vendimet e Gjykatës Supreme në lidhje me rastet që iu paraqitën. Hamendja rreth pranimit të delegatit Trifun Kostovski si "kandidat i pavarur" mbeti gjithashtu e pasqaruar. Në rubrikën "letrat e lexuesve" e përditshmja "Dnevnik" e botoi letrën e një lexuesi që saktësisht e tregoi kundërshtimin ligjor të zgjidhjes së tillë të problemit. Në të vërtetë, Kostovski nuk e ka zbatuar procedurën e kandidimit në bazë të numrit të parashikuar të zgjedhsëve, por kandidatura e tij ka qenë e verifikuar në bazë të propozimit të koalicionit zgjedhor "Për" dhe, më saktësisht, partisë SDSM. Prej këtu rrjedh qartë se ai nuk mundet dhe nuk guxon të ketë status të "deputetit të pavarur", aq më shumë pasi në situatë të ngjashme kanë qenë edhe dy kandidatë prej "propozuesëve të padefinuar", gjë që Komisionit iu dha të drejtë t'i regjistrojë si deputetë të propozuesit të tyre formal. Kësaj kundërdrejtësie lidhur me Kostovskin i ndërlidhet edhe rasti i delegatit Petar Naumovski, i cili në kundërshtim të hapur me ligjin mban angazhman profesional jashtë Kuvendit.

**Komiteti i Helsinkit i bën thirrje qeverisë së tanishme që t'ia bëjë me dije opinionit publik të gjitha thyerjet që janë bërë gjatë zgjedhjeve dhe masat që janë marrë ndaj thyersëve, si dhe t'i kryej të gjitha ndryshimet e duhura dhe plotësimet në rregulloren e ligjit dhe nënligjit, me qëllim që sa më shumë qytetarë të mund ta realizojnë tërësisht të drejtën zgjedhore, e të cilët do të votojnë në bazë të informatave të rëndësishme dhe pa presion ose kanosje të çfarëdolloji, që vijnë nga jashtë.**

**Profesionalizimi i komisionit zgjedhor dhe mundësimi i veprimtarisë se tij efektive gjatë gjithë periudhës për të cilën ky është i zgjedhur mund të shfrytëzohet për realizimin e këtyre aktiviteteve.**

## ***2. Liria e të shprehurit dhe mjetet e informimit***

Viti 2002 në pamje karakterizohet me zvogëlimin e gjuhës së urrejtjes që shprehej nëpër mjetet e informimit, përpjekje për informim objektiv, si dhe me rritjen e dhunës ndaj disa gazetarëve dhe mjeteve të caktuara të informimit.

Presionet dhe dhuna ndaj gazetarëve nisi qysh nga fillimi i vitit 2002 (me rastin e parandalimit të emitimit të Programit të tretë të radios maqedonase – "Radio kultura"), vazhdon me sulmin që iu bë ekipit të TV "Telmës" gjatë informimit nga mitingu i qetë i të punësuarve afër fabrikës AD "Gazela" (kur e rrahën edhe gazetarin Ljupço Jovkovski) dhe eskaloj në periudhën parazgjedhore me më shumë sulme të motivuara fizike (për të cilat sulme në mënyrë direkte ose indirekte mbanin përgjegjësi partitë që asokohe ishin në qeveri). Viktima të dhunës mbetën gazetarët: Mare Stoilova (TV "A1"), Simon Ilievski ("Utrinski vesnik"), Zoran Bozhinovski ("Radio Tumba"), Trajçe Stroimanovski ("Radio Probishtip"), Magdalena Andonovska ("Nova Makedonija"). Si përgjigje dhënë këtij hovi dhune ndaj gazetarëve, gazetarët organizuan protest me titull "Këtu jemi, rrihnani". Edhe më të shpeshta janë

presionet me karakter partiak (që i zbatojnë redaktorët kryesorë të mjeteve të ndryshme të informimit, të cilët i emërtojnë ose i përkrahin partitë), për shkak të të cilëve gazetarët, të cilëve u kanoset humbja e vendit të punës, janë të detyruar ta adaptojnë brendinë e informatave ose të heqin dorë krejtësisht nga ndonjë lloj i caktuar informimi.



**Komiteti i Helsinkit është i mendimit se presionet që u bëhen gazetarëve dhe mjeteve të informimit me qëndrime kritike, paraqesin thyerje të lirisë së informimit dhe lëndim të nenit 19 të Deklaratës universale për të drejtat e njeriut, si dhe të nenit 10 të Konventës së Europës për të drejtat dhe liritë e njeriut. Sipas Shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë (ShGM), në vitet e fundit ka pasur rreth dyzet raste të njohura të sulmeve fizike dhe llojeve të ndryshme të presioneve ndaj gazetarëve të këtij shteti, e kalkulohet me, së paku edhe po aq raste që nuk janë paraqitur për arsye të kanosjeve plotësuese dhe për arsye frike. Është e palejueshme që një shtet demokratik të ketë kryer hetuesi dhe të ketë sjellur aktvendim për vetëm njërin nga të gjitha rastet e këtij lloji.**

Nga ana tjetër, mjetet e informimit nuk mblodhën fuqi që t'i kundërvehen thyerjes të po kësaj të drejte të shprehjes dhe informimit kur u bë fjalë për raportin e Komitetit të Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në vitin 2001. Pjesa më e madhe e mjeteve të informimit e përmbajti kampanjën e ministrit të atëhershëm të punëve të brendshme, e disa prej tyre (si e përditshmja "Dnevnik" dhe TV "Sitel") dhanë një sërë të pavërtetash, dezinformatash dhe shpifjesh për kryetaren e Komitetit të Helsinkit, Mirjana Najçevskën, dhe anëtarin e Bordit të Komitetit, Sashko Todorovskin. Kah fundi i vitit 2002 vërehet ndryshim në këtë drejtim, kështu që një numër i madh mjetesh të informimit e ndërpret kampanjën kundër Komitetit të Helsinkit.

Përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe informimi joobjektiv (gjegjesisht informimi që me qëllim apo pa qëllim nxit mosdurim ndëretnik) nuk u ndërpre gjatë vitit 2002 (edhe përkundër asaj se gjatë kësaj periudhe mund të identifikoheshin ndryshime më të dukshme mes mjeteve të informimit lidhur me nivelin e informimit të tyre objektiv, si dhe të përdorimit të gjuhës së urrejtjes dhe nxitjes së mos tolerancës ndëretnike dhe mosdurimit ndëretnik). Le t'i përmendim këto shembuj: rastet që i tregoi Këshilli i radiodifuzionit të Republikës së Maqedonisë, në lajmërimin e vet dhënë opinionit publik, në të cilin konstaton se "dy emisione, në programin në gjuhën shqipe në MTV2 dhe në TV "Gurra" në Kërçovë, janë pjesë të emituara, gjegjesisht incizim integral, nga manifestimi i mbajtur në fshatin Sllupçan, me rastin e të ashtuquajturit "përvjetor i çlirimit të tij"; numri i madh shembujsh ku termi "maqedon" ndërrohet me terme tjera me kuptime pejorative; "informatat" e TV "Sitel-it" për përgatitjet e ofansivës në pranverë, në pjesën perëndimore të Republikës së Maqedonisë; "informatat" e gazetës "Flaka" që tregojnë se janë përjashtuar prej pune 20 policë, shqiptarë etnikë, që kanë qenë pjesë e projektit të OBSE – së; "informimi" i njëanshëm i mjeteve të informimit në gjuhën maqedonase dhe shqipe për ndodhitë lidhur me Shkollën fillore në Shemshovë; lajmërimi i pandjeshëm i mjeteve të informimit në gjuhën maqedonase në lidhje me shëndetin e nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme në Kumanovë; si dhe informimi joanalitik në lidhje me fletëpaditë penale dhe hapjes së procedurave gjyqësore në kampanjën antikorruptuese, por edhe rreth hovit të pakënaqësisë të punëtorëve dhe kërkesave të shumta për revizionimin e privatizimit.

**Komiteti i Helsinkit u bën thirrje mjeteve të informimit të nisin të zbatojnë ndjeshmëri më të madhe ndaj situatave që përfshijnë çështje të marrëdhënieve ndëretnike, si dhe ta rrisin nivelin e profesionalizmit gjatë informimit, gjë që do ta parandalojë lëndimin e dinjitetit njerëzor dhe do të sjellë deri tek respektimi i pafajshmërisë.**

### ***3. Sistemi i jurisprudencës dhe gjykata e pavarur***

Sistemi i jurisprudencës vazhdon rrugën e humbjes së pavarësisë dhe profesionalizmit në realizimin e funksioneve të veta. Padituria dhe mospërfillja e procedurave dhe formave me të cilat duhet zhvilluar procedura gjyqësore, si dhe lëndimet evidente në fushën e të drejtës materiale, jo vetëm që nxisin humbjen e besimit të qytetarëve tek sistemi i jurisprudencës, por edhe e pamundësojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në përgjithësi, e shpeshherë edhe vet paraqesin thyerje të drejtpërdrejta të këtyre të drejtave. Pakuptimshmëria e aktpadive të veçanta, mungesa e argumentimit elementar, ndërrimi dhe përshtatja e padisë gjatë procedurës gjyqësore, me qëllim që i gjykuari të mund të mbahet sa më gjatë në paraburgim, zvarritja e procedurave gjyqësore dhe mbajtja e njëanshme e tërë procedurës (vetëm si ilustrim mund t'i përmendim rastet e Vullnet Qazimit, Atanas Aleksovskit, Krenar Osmanit, Selam Selamit, Xhelad Elmazovit, Sabri Tairit) paraqesin sulm të drejtpërdrejtë ndaj të drejtës për gjykimin të drejtë, gjykim ky i cili i takon njëres prej të drejtave më të mbrojtura brenda një sërë aktesh ndërkombëtare, dhe që gjithashtu është qartë i definuar edhe në vet gjykatësinë e vendit.

Gjatë vitit 2002 u rrit dhe u bë i dukshëm ndikimi i pushtetit ekzekutues dhe i partive politike ndaj gjyqeve dhe prokurorisë publike. Çështja e pagesës joadekuate të gjykatësve u parashtua disa herë, duke përfshirë këtu edhe

mbikëqyrjen e cila zbatohet në atë mënyrë që rrogat e gjykatësve vijnë përmes Ministrisë së drejtësisë (e cila e mbikëqyr edhe vet lartësinë dhe shpërndarjen e rrogave).

Ndikimi ndaj këtyre institucioneve zbatohet përmes zgjedhjes së gjykatësve dhe emërimit të prokurorëve publik. Niveli i parë i këtij lloj ndikimi realizohet përmes ndikimit që e kanë partitë fuqiplota të qeverisë ndaj Këshillit të gjykatës, e i cili Këshillë është kompetent për selektimin dhe propozimin e gjykatësve të përshtatshëm për zgjedhje. Ndërkaq, nëse Këshilli i gjykatës "lëshon" në selektim propozim për gjykatës i cili nuk është sipas vullnetit të partive në fuqi, ai gjykatës përsëri nuk do t'i fitojë votat e duhura të mbledhjes së Këshillit. Gjatë vitit të kaluar kandidatët e propozuar për zgjedhje të gjykatësve disa herë e humbën përkrahjen e shumicës parlamentare, edhe përkundër rezultateve të prezantuara lidhur me punën e tyre, si dhe kompetencës dhe profesionalizmit të argumentuar. Çdo kandidat për gjykatës duhet të kalojë nëpër filtrat partiakë brenda komisioneve partiake të kuadrove. Nga ana tjetër, njerëz pa kurrfarë kualitetesh të vërtetuara, të cilët asnjëherë nuk kanë punuar nëpër gjyqe, por që kanë qenë aktivistë partiakë, u zgjedhën si gjykatës. I këtillë është rasti me, për shembull, gjykatësin e Gjykatës supreme që u zgjedh rishtas, i cili asnjëherë nuk ka qenë gjykatës, por vetëm aktivist partiak.

Si pikë posaçërisht e dhembshme, dhe si burim i kufizimit të vazhdueshëm të mandatit të gjykatësve (e me këtë edhe si mundësi e mbikëqyrjes së gjykatës) është pika 3 alinea 6 e nenit 99 të Kushtetutës, dhe neni 2 i Ligjit të Këshillit të gjykatës republikane me të cilët konfirmohet procedura për konfirmimin e propozimit për lëshimin e gjykatësve për shkak të "zbatimit joprofesional dhe të pandërgjegjshëm të funksionit gjykatësor". Ky përcaktim është keqpërdorur disa herë me veprim joadekuat dhe të paargumentuar kundër gjykatësve që nuk janë sipas vullnetit të strukturave udhëheqëse (ose që nuk janë nën mbrojtjen e drejtpërdrejtë të ndonjë partie politike). Qeveria e re shumë herët dhe në mënyrë shumë të ngjashme lëshoi nga puna dy gjykatës. Mungesa e argumentimit adekuat dhe veprimit serioz lidhur me këtë çështje paraqet vazhdimin e erozionit të gjykatës së pavarur. Në këtë drejtim mund të shpjegohet edhe insistimi i fundit i qeverisë së re lidhur me ndryshimin e Këshillit të gjykatës (sipas Qeverisë "*njëra nga prioritetet që qëndron në zbatimin e Marrëveshjes së Ohrit paraqet zgjedhjen e re të Këshillit të gjykatës republikane, duke qenë se këtë gjë e kanë urdhëruar ndryshimet e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë*"). Mirëpo, lajmërimi i Këshillit thekson se "nuk ekziston bazë kushtetuese për qasje në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të gjykatës republikane, sepse anëtarëve ekzistues ende nuk u ka kaluar mandati". Sipas nenit 104 të Kushtetutës, anëtarët e Këshillit zgjedhen për kohëzgjatje 6-vjeçare, e në pajtim me nenin 9 të Ligjit ekzistues për Këshillë të gjykatës republikane funksioni i anëtarit të Këshillit përfundon vetëm në rast të dhënies së dorëheqjes, me rast lëshimi për arsye dënimi për vepër të kryer penale me dënim të pakushtëzuar me burg, me kohëzgjatje minimale gjashtë mujore, ose në rast të humbjes së përhershme të aftësisë së kryerjes së funksionit. Sjellja e ligjit të ri nuk është njëra nga bazat e numëruara për pushimin e mandatit). Në situatë të këtillë është i prituri "afrimi" i Këshillit të gjykatës drejt strukturave qeveritare, gjegjësisht, veprim nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të këtyre strukturave.

Përveç zgjedhjes, qeveria ekzekutive dhe partitë politike kryejnë presion ndaj gjykatësve edhe gjatë sjelljes së vendimeve konkrete. Për shembull, në rastin e Vullnet Qazimit (shqiptim i dënimit të kushtëzuar për vepër penale –



Nxjitje rreziku të përgjithshëm, sipas nenit 288 të Ligjit penal), asnjë dëshmi nxjerrë gjatë procedurës hetuese, as gjatë hetuesisë kryesore, nuk tregonte se i gjykuari me të vërtetë e ka kryer veprën për të cilën gjykohej. Duket se me shpalljen e Vullnet Qazimit të fajshëm dhe me shqiptimin e dënimit të kushtëzuar me burg është bërë kompromis gjyqësor, që është i dëmshëm për gjykatën e Maqedonisë. Me atë që Qazimi ishte shpallur si fajtor dukej se dikush deshte disi t'i "mbulojë" shtatë muajtë që Qazimi i kaloi në privim. Si do që të jetë, ngel fakti se fajtorët e vërtetë ngelin - pa u dënuar. Komiteti i Helsinkit sinqerishtë shpreson se gjygi i apelit nuk do të tolerojë kesi lloj kompromisesh, si edhe pazarllëk me principet e jurisprudencës.

Si rezultat i presioneve të këtilla në vitin e kaluar nuk u udhëhoqën (për shembull rasti i anëtarëve të Bordit të KHM-së kundër të përditshmes "Veçer", që ende gjenden në sirtaret e Gjykatës themelore Shkup I – dhe për të cilin gjykata / gjykatësja Gordana Sajkova me këmbëngulësi) nuk cakton procedurë; ose në mënyrë joadekuate u udhëhoqën një sërë rastesh, procedurat zvarriteshin dhe anuloheshin (gjoja se për shkak të pamundësisë për t'i sjellur dëshmitarët ose për shkak të mungesës së ndonjërës nga palët), e në numër të caktuar rastesh gjykatësit iknin bile edhe t'i caktojnë procedurat. Në ratsin e Atanas Aleksovskit (ankesë dhënë pranë Gjykatës themelore Shkup II kundër kompanisë "Ohis" – Shkup) tri afatet e fundit të kësaj procedure anuloheshin për shkak se lënda, thjesht, u humb. Aleksovski përmend se lënda e njëjtë qenka zhdukur edhe në vitin 1993, kështu që i tërë materiali është ripërritur me sjelljen e sërishme të dëshmimeve. Me, thjeshtë, mosndërmarrjen e procedurës që është e drejtuar kundër qeverisë ose eksponentëve të saja, gjykatësit dhe gjykatat përpiqen t'u shmangen kolizioneve eventuale me qeverinë, e në këtë mënyrë drejtpërdrejtë i dëmtojnë qytetarët dhe e devalvojnë principin e mbizotërimit të së drejtës.

Ndikimi i partive ndaj gjykatës realizohet edhe me shpërnguljen e selive të sipërmarrjeve të caktuara nëpër territoret e gjykatësve që anojnë kah ndonjë parti e caktuar politike ose kah qarqe të caktuara biznesi, dhe të cilët do të dalin kompetentë në zgjidhjen e procedurave të ardhshme eventuale të atyre sipërmarrjeve. P.sh. "Makedonija Tabak 2000" dhe sipërmarrjet e saja e shpërngulën selinë e tyre në Shtip, Lozar-i prej Manastiri në Shkup.

Veçanërisht brengosin situatat kur gjykatësit u shmangen realizimeve të plota të procedurave në të cilat si të akuzuar paraqiten përfaqësues të Ministrisë së punëve të brendshme. Rasti i Toni Peshevskit nga Kumanova (Toni Peshevski dhe i ati i tij dhanë ankesë private për vepër penale - Lëndim i lehtë trupi – dhe aktpadi për vepra penale: Leçitje kundërligjore nga liria dhe Maltretim gjatë zbatimit të detyrës. Pas zvarritjes së procedurës për shkak të obstrukcioneve të të akuzuarit dhe dëshmitarëve-policë, ankesa private u hodh si apsolutisht e vjetëruar). I tillë është rasti me procedurat gjykatëse (rasti E.Xh. Gjykata themelore në Negotinë, rasti S.T., S.M, dhe e mitura S.M., Gjykata themelore në Strugë) të inicuar nga ana e zyrës private të HDZR "Hëna" – Gostivar kundër nëpunësve shtetërorë të Ministrisë së punëve të brendshme. I ngjashëm është edhe rasti i lëndëve të dhëna nga ana e Komitetit të Helsinkit (Muhamed Bela për arrestim joadekuat nga ana e policisë).

Situata e prokurorisë publike është e ngjashme me atë të gjykatave. Mënyra e propozimit dhe e emërimit të gjyguesve dhe të zëvendësve të tyre siguron ndikim të madh të qeverisë ekzekutive. Gjatë periudhës së kaluar Prokuroria publike paraqiste frenim në zbatimin e procedurave kundër përfaqësuesve të organeve shtetërore, dhe sidomos kundër të punësuarve në Ministrinë e punëve të brendshme, në rastet e shumta të keqpërdorimit të

detyrës dhe aplikimit evident të torturës dhe mundimit, gjatë zbatimit të detyrës. Në prokurorinë publike “ngecën” edhe procedurat e shumta të inicuar për shkak të kriminalitetit ekonomik dhe keqpërdorimeve tjera të funksionerëve të lartë të shtetit. Ndërkohë, për arsye dukshëm politike pranohen aktpadi penale kundër kundërshtarëve të shquar politikë. Me keqpërdorimin e institutit “udhëzim i domosdoshëm”, gjykuesve më të ulët u urdhërohej ndjekje penale të funksionerëve të mëparshëm të MPB dhe të PP (kundërshtarë aktualë partiakë). Njëra nga përparësitë e strukturës së re udhëheqëse ishte lëshimi i Prokurorit publik të shtetit. Edhe në këtë rast e tërë procedura ishte skajshmërisht e formalizuar dhe e thjeshtëzuar. Në situatë kur mund të jepeshin argumente relevante dhe të shumta në bazë të së cilave mund të kërkohej që Prokurori publik i shtetit të largohej nga detyra, nuk u dhanë as argumente minimale dhe nuk u krye procedurë serioze rreth këtij largimi. Kjo tregon se Prokurori publik shtetëror shihet si kuadro rreptësisht partiak, që duhet t’i mbrojtë interesat partiake të partive udhëheqëse.

Avokatët nuk patën sukses të qëndrojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ta iniciojnë aplikimin e dokumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Republikës së Maqedonisë. Në të kundërtën, gjatë vitit 2002 Dhoma e avokatëve solli edhe rregullore për ndërprerje pune të anëtarëve të Dhomës së avokatëve të Republikës së Maqedonisë, në të cilën mohohen rregullat e nenit 12, nenit 13 dhe nenit 18 të Ligjit të Avokaturës. Ndërkohë, me nenin 5 të Statutit të Dhomës së Avokatëve, ku kjo organizatë është e definuar si e detyrueshme, mohohet liria e shoqërimit dhe pavarësia e avokatëve gjatë kryerjes së detyrës së tyre. Rregullorja u aplikua në rastin e avokatit Nikola Petrov nga Strumica.

Gjatë muajit nëntor mjetet e informimit u ballafaquan me një fenomen specifik të praksës të gjykatës maqedonase. Në fjalë, në disa raste të ndryshme kur gazetarët kanë shprehur interesim për aktvendime të dhëna, paskan marrë përgjegjje se “nuk mund të kenë qasje”. Megjithatë, aspak nuk bëhet fjalë për “qasje”, por për shpjegim të gabueshëm dhe praksë të gabuar të gjykatave tona. Instituti “botimi i aktvendimit”, i parashikuar në nenin 344 të Ligjit për procedurë penale zëvendësohet me lajmërimin e padisë, edhe ate duke i lajmëruar, praktikisht, vetëm palët e involvuara (paditësin, të paditurin, e në varshmëri prej dënimit dhe rrethanave, edhe institucionin përgjegjës të burgut, të dëmtuarit dhe gjykatat tjera). Ky rreth i subjekteve është i parashikuar në një institucion tjetër – “Dhënia e padisë “ (neni 347/3-6 prej LPP). Në atë mënyrë mashtrohet instituti “dhënia e aktvendimit” edhe pse aktvendimi, si produkt i fundit i mendimit të gjyqit, do të duhej të prezantohet edhe formë ndikimi të gjyqit ndaj rrjedhave shoqërore, por njëkohësisht edhe formë konsiderate ndaj opinionit publik. Me mosshpallje opinionit publik i ndalohet të jetë kritik i punës së gjykatave, e nëse kësaj i bashkangjitet edhe principi i “pavarshmërisë së gjykatave”, gjykatat, faktikisht, bëhen të paprekshme.

**Komitetei i Helsinkit shpreh brengosje të madhe për shkak të erodimit të mëtutjeshëm të gjykatës dhe të varshmërisë së saj. Gjykata e pavarur paraqet bazën e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut, që gjatë vitit 2002 nuk mundi të realizohej, e poqese ky proces vazhdon edhe më tej, nuk do të mund të realizohet as në vitin 2003. Mungesa e gjykatës së drejtë i shndërron mbrojtësit më të mëdhenj të të drejtave të njeriut në thyerësit e tyre më të mëdhenj, e qytetarëve faktikisht ua merr mundësinë të qëndrojnë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre themelore.**



#### **4. Abuzimet policore**

Gjatë vitit 2002 nuk u ndërmorrën hapa drejt zvogëlimit të përdorimit të fuqisë joadekuate nga ana e policisë, përmirësimit të organizimit të policisë dhe ndërrimit të metodave të torturës me metodat e aplikimit të mjeteve të teknologjisë moderne në funksion të gjetjes dhe nxjerrjes para gjyqi të mbajtësve të veprave penale. E tërë kjo ndikoi që policia në shumë raste të shpallet si joefikase, nga njëra anë, dhe të bëhet thyerëse fuqiptotë e të drejtave dhe lirive të njeriut në funksion të patrive në fuqi, nga ana tjetër.

Numri më i madh i lëndimeve të të drejtave dhe lirive të njeriut është bërë nga ana e përfaqësuesve të njësive speciale në përbërjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme, por edhe keqpërdorimi i detyrës dhe sjellja brutale e forcave të rregullta policore vazhdon edhe më tej dhe nuk arrin të sanksionohet. Numri i rasteve të torturës policore u zvogëluar në krahasim me periudhën e konfliktit të armatosur, edhe pse edhe më tej ekziston në përmasa të mëdha. Le t'i përmendim si shembuj këta: Prefektin e Plasnicës, Ismail Jaoskin, e kanë rrahur në mënyrë brutale në stacionin e policisë së Prilepit (02.2002); të dyshimtin Vullnet Qazimin nga Tetova e kanë mbajtur 11 ditë në disa stacione të policisë, ku e kanë rrahur dhe maltretuar (pa ushqim e pa ujë), pa i lejuar kontakt me avokat; ekziston dyshimi se është kryer ekzekutim jashtëgjyqësor ndaj 6 shtetasve të huaj me rastin e "Vreshtave të Rashtanës" (03.2002); Fanija Vasilevskën e kanë fyer dhe rrahur në mënyrë brutale për shkak se është vozitur me avokat të përkatësisë tjetër etnike, me Naser Raufin; Cano Canevskin dhe Vebija Saloskin nga fshati Oktisi i kanë maltretuar rëndë rezervistët e policisë (04.2002); policia përdori forcë të panevojshme gjatë shpërndarjes së demonstratave që i organizoi Këshilli i sindikatëve (04.2002); më 15 maj, në afërsi të fshatit Leunovë të Gostivarit, gjatë demonstrimit të ushtrimeve të njësive policore për intervenime të shpejta, "Luanët", ministri i punëve të brendshme, Ljube Boshkovski, me të shtënë me hedhës automatik granatsh 30 metërsh, të ashtuquajtur "bretkocë", lëndoi disa nga të pranishmit (gazetaren e gazetës "Dnevnik", Daniela Veljanovskën, përkthyesen e Ambasadës së Francës, Anita Ramadanovën, shefin e polisisë së Shkupit, Marinko Kočovskin dhe vozitësin e tij, Kire Partaklievin). Kundër ministrit nuk u ngrit procedurë gjyqësore; Bojan dhe Dushko Arangellovi nga Koçani ishin viktimat të vetvullnetit dhe maltretimit të policisë (06.2002); Gjoko Dimeskin nga Prilepi e rrahi policia (07.2002); grupi i njësive speciale "Tigrat" në mënyrë të organizuar rrahu një grup qytetarësh nga Vinica me ç'rast një person ndërroi jetë, e dy tjerë u lënduan rëndë (07.2002); pjesëtarët e njësive speciale "Luanët" nuk i lejuan gazetarin të "Utrinski vesnik", Kosta Popovskit, të raportojë nga miniera e braktisur afër Kratovës (ku ministri i punëve të brendshme Ljube Boshkovski paska kërkuar flori); Ljubica Dimçevska, më 21 qershor, pa urdhër nga policia, e me asistimin e policisë, u vendos njëherë në Spitalin e sëmundjeve nervore dhe shpirtërore – Negorci, e mandej në spitalin në Bardovcë. Komiteti i Helsinkit konstatoi se Ljubica ka qenë e hospitalizuar pa bazë; më 5 tetor Sadulla Duraku, ish-pjesëmarrës i UÇK-së dhe tash më funksioner i lartë i BDI-së, u privua nga liria në bazë të urdhërit dhënë nga Gjykata themelore Shkup 2, ku ngarkohet për vepra të kryera penale "forma të rënda tradhëtie", "cënimi i integritetit territorial të Maqedonisë", si dhe për "krime lufte kundër popullatës civile", të kryera gjatë krizës së vitit të kaluar në Maqedoni. Sadulla Duraku u lirua pas disa "intervenimeve politike"; Çelebi Shemov, i akuzuar për vepër penale vjedhje të druve (11.2002) ka qenë i maltretuar gjatë sjelljes dhe hetimeve në stacionin e policisë. Pasi që e pranon

veprën e kryer penale, kërkon përgjegjësinë e policit, procedura e së cilës është në vijim e sipër.

Si problem mund të theksohet edhe përdorimi mbi normal i dhunës dhe veprimi joadekuat i policisë gjatë privimit, veprimi dhe privimi i personave nga bashkësia etnike rome, të burgosur gjatë kryerjeve të rishitjeve të vogla ose shvercit të vogël nëpër kufijë. Në disa raste befason brengosja e madhe dhe përkujdesi i policisë gjatë kërkimit të kryerësve të këtyre veprave thyrëse.



Edhe më tej brengos sjellja e policisë me të dyshimtit nëpër stacionet policore. Policia rrallë herë u ndihmon të dyshimtëve të gjejnë avokat, e vështirëson kontaktin me avokatin nëse i tilli ekziston, e pamundëson inkuadrimin aktiv të avokatit në hetuesi. Të burgosurëve nuk u mundësohet egzaminim korrekt mjekësor, e as kujdes mjekësor. Shumica e stacioneve policore nuk kanë vende adekuate për mbajtjen e personave, e as mjete për t'i ushqyer këta. Nëpër stacione nuk mbahen dosje adekuate për të gjithë personat e sjellur dhe të mbajtur në stacionet policore, e për ç'arsye nuk mund të regjistrohen të gjitha rastet e mbajtjeve të vazhduara. Nuk janë të definuara autorizimet lidhur me arrestimet dhe mbajtjet në polici.

Gjendja në KPU Idrizovë (ku mbahen të gjitha dënimet me burg në kohëzgjatje prej mbi dy vitesh, gjegjësisht, ku e mbajnë dënimin me burg të gjithë shtetasit e huaj pavarësisht nga dënimi) është katastrofale dhe nuk i kënaq as kushtet minimale për mbajtjen e dënimit në mënyrë humane. Vendet e mbajtjes së dënimit janë të vjetra dhe tërësisht të rrënosura, në dhomat e fjetjes qëndrojnë nga 20 njerëz, ndërresat janë të papastra dhe të grisura, vazhdimisht vjen erë e rëndë, kurse të burgosurit lahen një herë në 15 ditë (duke lëshuar ujë të nxehtë vetëm disa minuta). Gjatë muajve të dimrit ngrohja qendrore lëshohet 1-2 orë brenda ditës, gjë që nuk mundëson as ngrohje minimale të hapësirës. Të dënuarit që varen nga droga janë të mbyllur nëpër vende të posaçme me nga 20 veta, e ku shpesh vegjetojnë nëpër shtrate, pa asnjë tretman e as kujdes. Për shëndetin e të burgosurve kujdeset një mjek i praksës së përgjithshme (i cili shpesh mban politikë të pëlqimit ose mospëlqimit personal), kurse një herë në javë vjen një psihiatër. Rrahja e të burgosurve është mjete i mbajtjes së rendit dhe disiplinës në burg. Qelitë janë më shumë, vende për torturë dhe mundim, sesa vende për mbajtjen e dënimeve disiplinare. Renovimi i burgut që filloi,

pritet që në të ardhshmen ta ndërrojë këtë gjendje. Kushtet nëpër burgje janë kryesisht të këqija, nuk janë të rralla rastet e maltretimit fizik, shumë shpesh kufizohen të drejtat e garantuara të të burgosurve (vizita të anëtarëve të familjes, shetitjet e rregullta në ajër të pastër, përkujdesja adekuate e personave me probleme shëndetësore).

Brenda dy viteve të fundit Komiteti bëri tri vizita me qëllim të parandalimit të torturës (trupi i konvencës pranë Këshillit të Europës) pas së cilave pasuan dy raporte me vërejtje serioze për situatën e Republikës së Maqedonisë. Asnjëri nga raportet nuk u botua publikisht.

**Komiteti i Helsinkit është i mendimit se trajtimi forcave policore, në cilëndo qoftë formë të tyre, jashtë kornizave ligjore nuk mundet të mos rezultojë si shkatërrim i mëtutjeshëm i demokracisë. Vetëm në kushte të kontrollës së lartë demokratike policia – edhe ate policia moderne, mirë e përgatitur dhe e trajnuar – mund të jetë mbrojtëse e shoqërisë demokratike. Prandaj tani është edhe më me rëndësi që procedura gjyqësore të mbahet me aplikim adekuat dhe të tërësishëm të ligjeve për zbatimin në vepër të të drejtave të njeriut. Shumë shpesh policia përdor forcë si pasojë e mosorganizimit dhe papërgatitjes në zbatimin e obligimeve të veta. Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i përkrah përkujdesjet dhe rekomandimet të shprehura në raportet e Komitetit për preventivë nga tortura dhe e bën me dije seriozitetin e dukurive të maltretimit dhe mbajtjes jashtëligjore, që u përkasin atyre që seriozisht i tejkalojnë autorizimet policore, dukurinë e “solidaritetit” mes prokurorisë dhe gjykatës, bile edhe në rastet kur lëndimet janë të qarta dhe mirë të dokumentuara, ose qartë të drejtuara nga ana e viktimave, organizatat joqeveritare të vendit ose të huaja.**

## ***5. Marrëdhëniet ndërkombëtare***

Pas, në dukje, relaksimit të marrëdhënieve ndëretnike si rezultat i ndërprerjes së konfliktit të armatosur, e dukshme është tatëpjetëza e zhvillimit të tensioneve që rezulton në paralelizëm gjithnjë e më të dukshëm shtetëror, institucional dhe më të gjerë shoqëror, por edhe ndërrimi i multikulturalizmit në bikulturalizëm. Në fjalë, intenca e mbrojtjes të së drejtave të pakicave vazhdon të kufizohet në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve duke e lënë kështu pas dore (bile edhe duke e keqësuar) gjendjen e bashkësive tjera etnike. Një pjesë e përkatësive të bashkësive të caktuara etnike (të asaj turke, rome dhe vllehe) sinjalizojnë përjekje të asimilimit të dhunshëm nga ana e bashkësive më të mëdha etnike (nga ajo maqedonase dhe shqiptare).

Pjesëtarët e bashkësisë rome ende janë në situatë më të vështirë, e strukturat shtetërore nuk tregojnë asnjë interes në drejtim të përmirësimit të kësaj gjendjeje. Edhe pse kanë kuadro akademike, romët nuk punësohen në organet shtetërore dhe kanë probleme gjatë punësimit në Ministrinë e punëve të brendshme (në radhët e policisë së uniformuar). Në raste dëmtimeve të qarta sociale në akcionet me përmbajtje sociale, organet shtetërore nuk i marrin parasysh familjet rome (asnjëherë prej familjeve të lagjes më të dëmtuar të Velesit, “Mesnost Ramina”, nuk iu dha banesë). Veprimtaria e organeve kompetente më së shpeshti mbetet në nivel të premtimeve dhe raporteve bombastike që jepen në televizion (gjatë vizitës që e bëri në lagjen “Ramnina” në vitin 2000, presidenti Trajkovski premtoi ndihmë prej 2,5 milion markash për

zgjedhjen e problemit, por kjo megjithate mbeti vetëm si premtim; në vitin 2002 presidenti përsëri premtoi ndërtimin e 54 barakave; presidenti premtoi edhe ndihmë për sanimin e gjendjes që pasoi pas vërshimeve të fundit, që i shkatërruan shtëpitë e shumë familjeve romë në Kumanovë). Shteti nuk ka ndërmarrë asnjë akcion të vazhdueshëm afirmativ ose të organizuar në drejtim të përmirësimit të situatës së bashkësisë etnike romë.

Pjesëtarët e bashkësisë turke ankohen se vazhdimisht lihen pas dore dhe se shqiptarët u bëjnë presion të madh. Përveç kësaj, ata ankohen edhe për problemet e pazgjidhura të shkollimit (mësimi në gjuhën amtare), por edhe për pozitën e keqe sociale (posaçërisht banorët e fshatrave).

Edhe përkundër ekzistimit të disa shoqatave vllehe (e në kohë të fundit edhe organizimit të tyre politik), edhe më tej mbeten problemet lidhur me shuarjen e gjuhës vllehe (për shkak se mungon përkrahja e qeverisë për krijimin e kushteve të përdorimit dhe mësimi të kësaj gjuhe), si dhe çështja e regjistrimit të bashkësisë fetare, shërbimi i të cilës do të mbahej në gjuhën vllehe.

Të gjitha bashkësitë etnike joshqiptare reagojnë negativisht ndaj Marrëveshjes kornizë të Ohrit dhe e parashtrajnë çështjen e pjesëmarrjes së tyre në formulimin e thënieve të kësaj Marrëveshjeje. Ata posaçërisht reagojnë ndaj bipolaritetit që sipas tyre e promovon Marrëveshja.

**Komiteti i Helsinkit është i mendimit se në vitin 2002 është bërë marginalizim i dukshëm i ndikimit të pakicave joshqiptare dhe se shteti nuk i është përgjegjës pjesës më të madhe të thënieve të konvencës së Kornizës për mbrojtjen e pakicave nacionale. Në këtë drejtim brengos edhe e dhëna se Republika e Maqedonisë ende nuk ka dhënë raport në lidhje me implementimin e kësaj konvente, edhe përkundër obligimit që rrjedh nga ratifikimi i saj.**

Për sa u përket marrëdhënieve mes shoqërisë maqedonase dhe asaj shqiptare, në pjesën e parë të vitit dukej sikur situata nisi sadopak të lehtësohej. Patrollat e policisë me përbërje të përzier etnike bëmë formalisht e realizuan planin e kthimit të policisë në vendbanimet që i pati përfshirë konflikti. Karakteristike për këtë proces është ajo se në disa raste (gjatë arrestimeve që i bëri policia mes popullatës shqiptare) popullata lokale i bllokonte rrugët dhe e ndalonte hyrjen e patrollave me përbërje të përzier nëpër disa fshatra të dhëna. Në të gjitha këto raste ishte e nevojshme që të asistojë faktori ndërkombëtar.

Më 9 janar të vitit 2002 priftërinjtë e Kishës ortodokse maqedone u ndanë pllaka me kryq të gravuar dhe me lutje ortodokse njëerës prej bazave të policisë në afërsi të Shkupit, pastaj anëtarëve të njësisë speciale "Tigrat" dhe njësisë për qëllime speciale "Luanët", si dhe njësisë speciale antiterroriste të Ministrisë të punëve të brendshme. Në këtë ceremoni rasti morri pjesë Arqipeshkvi i Ohrit dhe i Maqedonisë, z.z. Stefani, premieri, Ljubčo Georgievski dhe disa ministra të Qeverisë. Komiteti i Helsinkit e gjykoi rreptësisht identifikimin e këtyre etno-religjioz të cilësdo pjesë të përbërjes së Ministrisë së punëve të brendshme.

Në periudhën parazgjedhore u themelua parti e re politike (BDI), e përbërë para së gjithash prej pjesëtarëve dhe simpatizuesëve të UÇK-së që vepronte gjatë periudhës së konfliktit. Subjekti i ri politik e nxiti nga njëra anë radikalizimin e VMRO-DPMNE-së (e që fitoi burim të përhershëm të pengimit të qeverisë së re, të përbërë nga "ish-terroristë") dhe, nga ana tjetër, radikalizimin e PDSH-së dhe PDP-së (që përpiqen ta vazhdojnë vijën radikale të UÇK-së).

Janë bërë më shumë ndryshime në Kushtetutë (amandamente) dhe është sjellur Ligji për amnesti. Në mungesë të kampanjës më të gjerë, dhënies së shpjegimeve dhe propagimit të ndryshimeve të sjellura, pjesëtarët e bashkësisë etnike maqedonase (por edhe bashkësitë tjera etnike) shfaqën rezistencë të madhe ndaj ndryshimeve të bëra dhe të propozuara, gjegjësisht pakënaqësi për shkak të ngathësisë, ose pamjaftueshmërisë së ndryshimeve (gjë që u shfaq tek pjesëtarët e bashkësisë etnike shqiptare).

Probleme të posaçme paraqiten rreth shpjegimit dhe (mos)zbatimit të Ligjit për amnesti. Asnjë nga subjektet që i përfshiu ky ligj (pjesëtarët e UÇK-së, qytetarët e akuzuar për terrorizëm, Prokuroria publike, gjykatat, drejtoritë e burgjeve, avokatët) nuk e aplikojnë këtë ligj në procedurat adekuate, gjë që nxit tensione të vazhdueshme dhe shkelje të të drejtave të njeriut. Që kur u paraqit, ky ligj paraqet pengesë në procesin e ndërtimit të besimit mes bashkësive etnike. Pjesë e madhe e pjesëtarëve të bashkësisë etnike maqedonase këtë ligj e përjeton si padrejtësi të ligjëfuqishme, kurse pjesë e madhe e pjesëtarëve të shoqërisë shqiptare mospërfilljen e këtij ligji dhe moszbatimin e tij e marrin si shenjë mosrespekti të Marrëveshjes së Ohrit dhe si themel që do ta kishte vazhduar edhe më tej konfliktin.

Përdorimi i gjuhëve në Republikën e Maqedonisë gjithashtu paraqet pengesë edhe për qeverinë e re. Kuvendi ende nuk ka ratifikuar ligje të reja që do ta regullonin përdorimin e gjuhëve në organet shtetërore (e as ligje për dhënien e dokumenteve personale në pajtim me nenin 7 të Kushtetutës, që u ndërrua), edhe pse bëhet fjalë për obligime që duhej t'i kishte kryer qysh përbërja e mëparshme (neni 8 i aneksit B). Prej këtui, edhe konflikti juridik që u zhvillua lidhur me atë se në cilën gjuhë duhet mbajtur mbledhjet e komisioneve të Kuvendit, kur këto i kryesojnë shqiptarë etnikë, nuk mundi të zgjidhet vetëm me shpjegimin e nenit 3 të Rregullores së Kuvendit, duke qenë se neni i përmendur lejon shpjegime të ndryshme.

**Gjatë vitit 2002 nuk u vendos besimi mes bashkësisë etnike maqedonase dhe shqiptare dhe nuk u krijuan kushte për veprim të mëtutjeshëm të përbashkët dhe zhvillim të institucioneve demokratike. Pas zgjedhjeve u bë kompromis i ri politiko-partiak i cili siguron ndarje dhe funksionim të qeverisë, e që megjithatë nuk e stimulon ndërtimin e shtetit juridik si bazë e një dialogu më kompleks ndëretnik dhe si garancë e mbajtjes së këtij procesi.**

Ka indikacione se në mjediset e përziera etnike në të cilat dominon ndonjëra prej grupeve etnike rritet presioni ndaj popullatës pakicë gjë që rezulton me krijimin e regjioneve etnikisht të pastra (shpërngulja kryhet brenda territorit të një qyteti ose mes qyteteve, gjegjësisht, prej fshati në qytet). Faktikisht, si rezultat i konfliktit të armatosur u thellua ndarja mes pjesëtarëve të shoqërisë maqedonase dhe asaj shqiptare. Gjatë vitit 2002 jo vetëm që nuk u vendosën forma të reja komunikimi dhe bashkëpunimi, por u theksuan dallimet, që solli një sërë konfliktesh më të vogla të cilat nuk e lejojnë stabilizimin e situatës.

Problemi më i madh paraqitet në fushën e arsimit. Shteti nuk përpunoi strategji të posaçme për ndryshime përmbajtësore dhe organizative nëpër shkolla, në kahje të promovimit të tolerancës, respektit të dallimeve dhe të drejtave të njeriut. Si rezultat i kësaj erdhi deri tek: dezintegrimi i shkollave etnikisht të përziera; tensionet e vazhdueshme ndëretnike për shkak të kërkesave të bashkësisë etnike shqiptare për ndryshimin e emrave të shkollave

(vënjen e emrave të pjesëtarëve të shquar të bashkësisë shqiptare të Republikës së Maqedonisë, si dhe të veprimtarëve kulturorë e të tjerë) dhe ndërtimin e simboleve të vetëqenies shqiptare, gjegjësisht maqedonase, para shkollave (buste të "herojëve" nga e kaluara e afërme ose e largët).

Ende nuk është përmbyllur rasti me të zhdukurit. Familjet e të zhdukurve - 12 maqedonas, 6 shqiptarë dhe një nështetas bullgar – ende nuk kanë kurrfarë njohurish për të afërmit e tyre. Organet kompetente shtetërore pothuajse nuk kanë ndërmarrë asgjë lidhur me gjetjen e personave të zhdukur. Më 29 nëntor të vitit 2002 premieri i ri dhe ministri i punëve të brendshme premtuan se pas 30 ditësh do të dalin me informata konkrete që do ta sqarojnë rastin. Opinioni publik nuk ka informata që do të kishin dëshmuar se janë bërë hapa drejt plotësimit të premtimit të dhënë.

**Mungesa e strategjisë së ndërtimit të besimit dhe promovimit të multikulturalizmit si bazë e Republikës së Maqedonisë, krijon kushte për thellimin e mëtutjeshëm të ndarjes mes shoqërisë etnike maqedonase dhe asaj shqiptare, për manipulime të mundshme nga ana e partive ose grupeve të radikalizuara (por edhe të strukturave udhëheqëse dhe partive që e përbëjnë qeverinë) dhe për konflikt të mundshëm në të ardhshmen në territorin e Republikës së Maqedonisë.**

## ***6. Personat e çvendosur të brendshëm dhe refugjatët***

Sipas të dhënave të Kryqit të kuq numri i personave të çvendosur gjatë krizës arriti 70.000. Në fillimin e vitit 2002 ky numër u zvoglua në 16.500, kurse sipas të dhënave nga nëntori i vitit 2002 në territorin e shtetit kishte 9.500 persona të çvendosur të brendshëm dhe rreth 1.600 persona që nuk janë kthyer nga Kosova. Pjesa dërmuese e personave të çvendosur të brendshëm janë të strehuar në qendra kolektive (72%), kurse të tjerët në familje të të afërmeve dhe miqëve. Strehimi është jopërkates në lidhje me numrin e anëtarëve të disa familjeve dhe nuk mundëson kushte të shëndosha dhe higjienike, nuk siguron kushte minimale për zhvillimin përkatës të fëmijëve. Pjesa kryesore e ndihmës humanitare për këto persona vjen nga dhuruesit e jashtëm dhe parashikohet që në fillim të vitit 2003 tërësisht të ndërpritet. Ndryshe nga standardet ndërkombëtare, në Marrëveshjen kornizë nuk janë parashikuar zgjidhje alternative për problemin e personave të çvendosur të brendshëm, për vetëm një gjë: kthimi i të gjithëve në vendbanimet e mëparshme. Me qëllim të pengimit të pastrimit etnik të territoreve të konfliktit të vitit të kaluar dhe duke u mbështetur nga komuniteti ndërkombëtar, shteti insiston (në nivel të detyrimit dhe kërcënimit) të gjithë personat e çvendosur në një afat sa më të shkurtër të kthehen në vendbanimet e tyre. Lidhur me këtë problem jo vetëm që nuk ofrohen zgjidhje tjera të mundshme, por nuk plotësohen as standardet minimale për një kthim të këtillë. 1). Nuk janë rindërtuar shtëpitë më të dëmtuara, 2). Shtëpitë e rindërtuara janë pa paisje elementare shtëpiake, 3). Njerëzve nuk u është paguar kurrfarë dëmshpërblimi për dëmet e shkaktuara sidomos në kafshët e vrara dhe për zhdukjen e të mirave fshatare nga bombardimet e armatës. 4). Nuk është siguruar rrjeti i nevojshëm i infrastrukturës (atje ku janë rindërtuar ambulancat shpeshëherë s'ka mjekë dhe personel tjetër mjekësor), 5). Nuk ka garanci minimale për jetën, pronën dhe sigurinë e qytetarëve, 6). Një pjesë e shtëpive të rindërtuara të Maqedonasëve dhe Serbëve etnik sërish janë rrënuar dhe plaçkitur (në fshatrat e Tetovës – Jedoarcë, Otunjë dhe Setollë, si dhe në Haraçinë). Për

shkak të mbrojtjes së të drejtave të tyre, personat e çvendosur të brendshëm kanë formuar dy shoqata, të cilat pa sukses tentojnë të vendosin dialog përkatës me përfaqësuesit e pushtetit. Po përgatiten shumë padi private kundër shtetit për arsye të kompenzimit të dëmit të shkaktuar në kohën e konfliktit të armatosur. Në dhjetor të vitit 2002 është formuar një trup i ri për zgjidhjen e gjendjes së personave të çvendosur të brendshëm. Në këtë trup nuk është i pranishëm përfaqësuesi i personave të çvendosur të brendshëm.

Në shtet gjenden rreth 3.000 refugjatë të kombësisë joshqipëtare (më së shumti Romë, Egjiptas dhe Ashkali) nga hapësira e Kosovës (një pjesë e refugjatëve janë të vendosur në kampe, kurse pjesa tjetër nëpër familje). Në kampin në Katllanovë janë të strehuar 409 refugjatë, kurse në komunën e Shuto Oruzarit privatisht janë strehuar 450 refugjatë. Ndërkaq, në kampin në Shuto Orizare janë të vendosur 1088 refugjatë prej të cilëve 430 janë fëmijë të moshës deri 16 vjeçare, nga të cilët vetëm 60 fëmijë e vijnë në mësimin në shkollat fillore, kurse vetëm një vijon shkollën e mesme. Këta refugjatë jetojnë në një varfëri të plotë, pa mbrojtje elementare shëndetësore, pa kushte themelore higjienike, me ushqim minimal dhe pa kurrfarë kushte për përkujdesje dhe arsimimin e fëmijëve, me status të pazgjidhur të refugjatëve, pa mundësi që legalisht të punojnë për të siguruar ekzistencën. Kthimi i këtyre njerëzve në Kosovë është i pamundshëm për shkak të kërcnimeve të drejtëpërdrejta dhe indirekte nga ana e përfaqësuesve të bashkësisë shqiptare dhe pamundësia e forcave ndërkombëtare ta sigurojnë mbrojtjen e tyre përkatëse. Veçanërisht shqetëson pozita e fëmijëve që nuk e vijnë rregullisht mësimin dhe jetojnë në kushte tepër jopërkatëse të dëmshme për shëndetin dhe zhvillimin e tyre. Pjesa më e madhe e këtyre personave nuk e shohin ardhmërinë e vet në Republikën e Maqedonisë dhe kërkojnë trajtim përkatës nga ana e vendeve evropiane (të cilat i konsiderojnë për fajtor të drejtëpërdrejtë për gjendjen e tyre, për shkak të intervenimit në Kosovë).

**Zgjidhja e çështjes së personave të çvendosur të brendshëm paraqet problem delikat, si nga aspekti i dispozitave të Marrëveshjes kornizë të Ohrit (sipas të cilës shteti e ka marr përgjegjësinë për kthimin e të gjithë personave të çvendosur në shtëpitë e tyre), ashtu edhe nga aspekti i mbrojtjes së të drejtave të tyre që është poashtu përgjegjësi e vet shtetit. Përgjegjësjia e shtetit në këtë rast është e fuqizuar me faktin se situata në të cilën gjenden këto qytetarë është shkaktuar drejtëpërdrejt nga aktivitetet e shtetit dhe nga politika që e ka zhvilluar vet. Detyrimi për kthim në kushte të mungesës së plotë të besimit dhe mungesës së garancës të sigurisë elementare të jetesës, paraqet shkelje edhe më të madhe të të drejtave të këtyre qytetarëve dhe sjellja e vetëdijshme në rrezik të jetës së tyre dhe integritetit fizik.**

## ***7. Tregëtia me njerëz***

Tregëtia me njerëz bëhet problem i cili gradualisht e tërheq vëmendjen e shtetit edhe të opinionit. Ndryshimi i bërë në Kodin penal (në të cilin formulohet vepër e posaçme penale e ndërlidhur me tregëtinë e njerëzve, neni 418-a) nuk është përcjellur me ndryshime të dukshme praktike dhe me veprimin e organeve shtetërore. Përkundër asaj që në masë të madhe janë identifikuar qendrat ku qëndrojnë femrat, viktimë të tregëtisë me njerëz, sikurse edhe pjesëmarrësit kryesor dhe kanalet tranzite, nuk po zbatohet një aksion i organizuar dhe agresiv



në drejtim të pengimit dhe ndëshkimit të këtyre aktiviteteve kriminele. Nxitja dhe përfundimi i disa procedurave penale në këtë fushë paraqet një shenjë pozitive, por është e pamjaftueshme për një ndryshim qenësor në luftën me këtë lloj cënimi të të drejtave të njeriut. Republika e Maqedonisë tanimë nuk paraqet vetëm zonë tranzitimi të tregëtisë me njerëz, por edhe destinacionin e fundit.

Sipas të dhënave zyrtare, në Maqedoni ka rreth 300 lokale të natës, prej të cilëve më shumë se 100 gjenden në Tetovë dhe rrethinë. Prej tyre vetëm një numër i vogël janë jolegale, përkatësisht nuk e kanë lejen e nevojshme për punë. Në këto lokale vajzat-viktima të tregëtisë me njerëz, në të shumtën e rasteve në pamje të parë janë të punësuar në mënyrë të rregullt si kamariere ose vallëzuese, mirëpo mbi ata vendoset një raport i tërësishëm robërues: punojnë pa kurrfarë kompenzimi, qëndrojnë në lokale pa kushte minimale higjienike dhe stërshiten midis pronarëve të lokaleve të natës. Shpesh, veçanarisht në mjediset rurale, viktimat e tregëtisë me njerëz janë të detyruara të mirren me prostitucion edhe në kafene dhe çajtoje të riadaptuara.

Problemet me këtë lloj kriminaliteti s'mund të zgjidhen lehtë, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, janë involvuar biznes-rrethe të caktuara, sikurse edhe funksionar të lartë nga pushteti dhe policia. Mbi organet hetuese shpesh bëhet presion i fuqishëm për fshehje, përkatësisht për mosmarrjen e masave kundër personave të caktuar të involvuar në këtë lloj kriminaliteti. Poashtu, probleme ka edhe me vetë viktimat e tregëtisë me njerëz, të cilët s'kanë besim në policinë, sepse shpeshëherë shërbimet e tyre i kanë shfrytëzuar edhe personat në uniformë (të cilët jorrallë janë të ndërlidhur me tregëtarët me njerëz ose janë shfrytëzues të shërbimeve në objektet e tyre). Pavarsisht nga ndryshimet në pushtet, në nivelin e eks-territoritoreve veçohen vendet si: Veleshta, Ladorishti, Bogovina dhe Kamenjari.

Në praktikën gjyqësore, ende viktimat e tregëtisë me njerëz, posaçërisht vajzat që seksualisht eksploatohen, trajtohen si prostitute, prandaj kryerësit merren në pyetje në bazë të nenit 191 të Kodit penal, përkatësisht "Ndërmjetësimi në kryerjen e prostitucionit". Nga ana tjetër, shpeshëherë s'mund të sigurohet prania e viktimave të tregëtisë me njerëz gjatë procedimit hetimor ose në procesin kryesor, si të dëmtuar ose si dëshmitare, sepse ata janë shtetase të huaj dhe pa dokumenta për identifikimin personal, prandaj menjëherë dëbohen nga territori i Republikës së Maqedonisë. Në zbutjen e këtij problemi kontribuon Organizata ndërkombëtare për migracione (IOM), e cila e mbështet hapjen e qendrës tranzitore në Shkup, në të cilën pranohen dhe strehohen viktimat e tregëtisë me njerëz, deri në momentin e dëshmimit para gjyqit. Ka indikacione se në këtë qendër bëhet seleksionimi në pranimin e femrave të cilat ilegalisht qëndrojnë në territorin e Republikës së Maqedonisë (që është rasti me pjesën më të madhe të viktimave të tregëtisë me njerëz).

**Problemi i tregëtisë me njerëz ende s'është ngrritur në nivelin e prioritetit dhe nuk ndërmerren veprime sistematike e të continuara në drejtim të ndërprirjes të kanaleve të tregëtisë me njerëz, zbulimit dhe çlirimit të femrave të cilat kundër vullnetit të vet dhe me kërcnim gjenden në "shtëpitë për zbavitje" gjithëkund në Maqedoni dhe paraqitja para gjyqit dhe sanksionimi i kryerësve të veprimeve kriminele. Pamundësia që ky lloj kriminaliteti të kryhet pa involvimin aktiv i pjesëtarëve të Ministrisë për punë të brendshme nënkupton edhe nevojën nga një akcion të gjerë të brendshëm për zbulimin dhe nxjerrjen e tyre para gjyqit.**

## **8. Te drejtat sociale dhe punuese**

Në vitin 2002, në shtet po rritet varfëria, po bien standardi i popullatës, kurse prodhimtaria industriale po shënon trend negativ. Në Maqedoni janë regjistruar 78.000 amvisëri, përkatësisht 308.000 persona si raste sociale, që marrin ndihmë sociale në lartësi prej 2.500 denarë (rreth 40 euro) në muaj, për katër anëtarë, gjithësej. Sipas disa hulumtimeve, çdo i pesti qytetar është i uritur, përkatësisht s'ka mjete të mjaftueshme për ekzistencë, ndërsa varfërisht jetojnë 22,3% të popullatës. Përqindja e papunësisë e arriti numrin e pabesueshëm prej, pothuajse, 50% të papunësuar nga popullata e përgjithëshme e aftë për punë. Gjendja e këtillë e popullatës e sjell në pikëpyetje në përgjithësi mundësinë për praktikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Në sferën e ekonomisë vazhdojnë trendet negative. Pjesëmarrje të rëndësishme në situatën negative ekonomike kanë shpenzimet (të arsyeshme dhe të paarsyeshme) që shteti i kishte në lidhje me konfliktin e armatosur një vit përpara dhe shuarja e prodhimtarisë dhe e tregëtisë në zonat e përfshira në konflikt. Ndërkaq, ajo në bazë është edhe rezultat i drejtimit të vazhdueshëm jopërkatës me kapacitetet ekonomike, privatizimet e kryera joligjore (të filluara qysh në mandatin e garniturës së mëparshme politike), keqpërdorimi i pushtetit në funksion të sigurimit të dobisë personale dhe partiake nga ana e partive në pushtet VMRO-DPMNE-së dhe PDSH-së. E gjithë kjo periudhë karakterizohet me tension të rritur social dhe çënimin e pjesës dërmuese të të drejtave punuese dhe sociale të qytetarëve. Pjesa më e madhe e rasteve të ankesave nga ana e qytetarëve, që vijnë në Komitetin e Helsinkit në pjesën e dytë të vitit 2002, janë pikërisht nga kjo fushë.

Kontribut kolosal në këtë trend negativ dha zgjidhja, përkatësisht likuidimi i sipërmarrjeve-falimentuese. Sipas rregullave mbyllja ose transformimi i këtyre sipërmarrjeve dhe rrumbullakimi i procesit të privatizimit bëhej me mosrespektimin flagrant të rregullativës ligjore. Shembull tipik për këtë janë fabrikat, sipërmarrjet dhe minierat: Buçim, Jugohrom, Gazella, FAS "11 Oktomvri", Sasa, kurse veçanërisht në periudhën e fundit, praktika e privatizimit të këtillë shihet në rastet me Shtëpinë gazetare-botuese Nova Makedonija, Llozar nga Manastiri etj. Në pjesën më të madhe të këtyre rasteve parashtrohet pyetja jo vetëm për rregullësinë e procedurave, por përgjithësisht për ekzistimin e bazës për fillimin e procedurës falimentuese (siç është rasti me fabrikën Gazella). E gjithë kjo rezultoi me greva të shpeshtuara, me ç'rast ndodhte që të punësuarëve t'u ndalohej madje edhe e drejta e grevës. Këtu duhet të nënvizohet edhe e dhëna se shpeshëherë gjatë grevave ose shprehjeve ose pakënaqësisë të personave të punësuar në ato sipërmarrje, nga ana e drejtorisë përdorej edhe forca fizike përmes angazhimit të kompanive për sigurim ose keqpërdorimi i organeve të rendit dhe paqes. Gjatë pjesës së parë të vitit 2002, pas ndërrimit të udhëheqësisë në Sindikatat e Republikës së Maqedonisë, u organizuan greva masive me të cilat bëhej presion mbi Qeverinë, veçanërisht gjatë negociatave me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Botërore. Qëllimi i këtyre grevave dhe demonstratave ishte që rroga minimale në sektorin publik të jetë 5.060 denarë (përafërsisht 80 euro), për çka Qeveria, përkundër shtyerjes së gjatë, vendosi që ta zbatoj këtë vendim. Komiteti i Helsinkit konsideron se është e qartë mosmbajtja e llogarisë për nevojat dhe të drejtat e vërteta të qytetarëve të Maqedonisë nga ana e Qeverisë dhe se është fjala për lëshime politike në funksion të qetësimit të tensioneve sociale, madje edhe

kalkulimi parazgjedhor. Në këtë mënyrë, qytetarët vehen në situatë që të drejtat e veta t'i realizojnë kryesisht dhe vetëm përmes institucioneve të ashtuquajturës “demokracia e rrugës” në vend përmes institucioneve të sistemit me çka minohen shtyllat e demokracisë autentike qytetare.

Viti i kaluar karakterizohet edhe me paraqitjen e theksuar të punësimeve partiake dhe lëshimeve nga puna në Sektorin publik dhe avancimi në shërbim sipas parimit partiak, e kjo veçanërisht ishte e shprehur në periudhën para zgjedhjeve parlamentare të mbajtura më 15 shtator. Masovikisht shkeleshin procedurat ligjore për punësim, me ç'rast roli i Agjencionit për nëpunësit shtetëror u marginalizua (për shembull rasti i Sanije Hasiqit e punësuar nga ana e ministrit për drejtësi Ixhet Memeti, pa i plotësuar kushtet dhe pa e kaluar testin e Agjencisë së nëpunësëve shtetëror). Lëshimet nga puna, madje edhe shkarkimet me vetëdëshirë, janë të ndërlidhura me cënimet e mëdha të drejtave punuese të qytetarëve nga ana e organeve shtetërore-punëdhënësit (rastet: Ollgica Trajkovska nga Ministria për kulturë e cila përkundër procedurës jopërkatëse të shkarkimit nga detyra, s'mund t'a rregullon madje as statusin e vetë për shkak të obstrukcioneve në dhënien e dokumentacionit nga ana e ish-punëdhënësit-Ministria për kulturë, ose, rasti i Snezhana Lullevskës nga Agjencioni për zhvillim dhe investime, e cila nuk mundi të punësohet për shkak të dokumentacionit jo të plotë të siguruar nga ana e punëdhënësit të saj të mëparshëm – Agjencionit).

Në nëntor dhe dhjetor, pushteti i ri i konstituar filloi me ndryshime në administratë dhe u shpalli “luftë” korrupsionit dhe kriminalitetit “shtetëror”. Komiteti i Helsinkit i përshëndet të gjitha përpjekjet për vendosjen e qeverisjes së të drejtës dhe sanksionimin e procedurave të shkeljes së saj, por kundërshton ashpër secilën formë të veprimit jojuridik kundër padrejtësisë. Veçanërisht brengos ajo që pushteti i ri e vazhdoi praktikën e strukturës së mëparshme, të ndërrimeve dhe suspendimeve të paargumentuara në procedura në të cilat nuk respektohen: e drejta e procedurës korrekte, e drejta e ankesës, prezumcioni i pafajshmërisë dhe parimi i kundërshtimeve, që janë pjesë nga e drejta e mbrojtjes dhe janë të domosdoshme në të gjitha llojet e procedurave. Në procesin e ndërrimeve kadrovike në organet e administratës, të cilat qartazi nuk mund të ndërlidhen me fushatën kundër korrupsionit (edhe përkundër asaj që zhvilloheshin nën preteksin e saj), veçanërisht shqetëson mosrespektimi, madje edhe mohimi i hapur i Ligjit për nëpunësit shtetëror (si për shembull: me rastin e ndërrimit të drejtorit të Agjencionit për nëpunësit shtetëror, ose ndërrimit të drejtoreshës së Qendrës ndërkomunale për mbrojtje sociale, përkatësisht, procedurës kundër këshilltarit shtetëror për punë organizative në Ministrinë për punë të jashtme), e me këtë edhe blokimi i Agjencionit për nëpunës shtetëror, si organ i cili vendos për ankesat kundër masave dhe suspendimeve disiplinore.

Qeverija madje në vitin parazgjedhor filloi me ndërtimin dhe shpalljen e të ashtuquajturave banesa sociale. Është fjala për banesa që ndahen përmes konkursit pas një procedure të caktuar me plotësimin e kriterëve të definuara për kategorinë e rrezikuar sociale të qytetarëve. Me këtë rast, Ministria për transport dhe komunikacion nuk e respektoi obligimin të punoj në mënyrë transparente, me respektimin e procedurës dhe të kriterëve për çka u shkaktua revoltë të qytetarët të cilëve madje u është marrë edhe e drejta e kontrollit në dokumentacionin me çka nuk u është dhënë mundësia të paraqesin edhe protesta (kundërshtime). Anulimi i konkurseve nga ana e Qeverisë së re pasoi si rezultat i presionit të madh të qytetarëve, ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit (Ombusmani) dhe institucionet tjera kompetente. Anulimi i konkurseve

(mbështetur edhe nga Zyra e Avokatit të Popullit), paraqet zgjidhje me padrejtësi të një situate të padrejtë, që sërish sjell deri te shkelja e të drejtave pikërisht të qytetarëve që duhet të jenë të mbrojtur. Në vend që Qeveria të bëjë revidimin vetëm të zgjedhjes dhe të anulohen ose të mosnënshkruhen vetëm ato kontrata me personat që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpalljet, gjegjësisht në Vendimin ekzistues për mënyrën dhe procedurën për ndarjen e banesave, Qeveria e thëllon shkeljen e të drejtave të të gjithë personave që i kanë plotësuar kushtet që të marrin banesë me qira.

Përveç krizës së përgjithshme ekonomike dhe nivelit jashtëzakonisht të ulët të standardit social, frustracion plotësues për qytetarët paraqet edhe jokooperativiteti i bankave në Republikën e Maqedonisë në lidhje me dhënjën e kredive për banesa. Në sajë të faktit se këto kredi sipas rregullës janë hipotekare, kurse kamata është shumë e lartë dhe është midis 15% dhe 19% (kamata vjetore), po krijohet një situatë e njëfarë robërimi debitor, që në mënyrë eksplicite ndalohet në Konventën evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Një nga masat e para të Qeverisë së re është ribalansi i buxhetit me qëllim të plotësimit të obligimeve të papaguara të shtetit. Me këtë ribalansim do të kënaqen një pjesë e kërkesave të punëtorëve që janë në grevë, mirëpo nuk parashihet plotësimi i obligimeve në lidhje me: personat e invalidizuar, pensionistët dhe fëmijët që marrin shtesë fëmimore. Në këtë mënyrë Qeveria bën një selekcion në të cilin i lë anash pikërisht grupet më të ndijshme të popullatës (ose ata që s`mund të kryerjnë presion mbi pushtetin). Në këtë drejtim janë edhe paralajmërimet më të reja për privatizimin e foshnjoreve, shtëpive të pleqëve, qendrave për persona me sfida të posaçme dhe të pushimoreve të fëmijëve, që në kushte të rrënies absolute të standardit dhe papunësisë enorme, do të thotë evitimi i shtetit t`u përgjigjet obligimeve të veta ndaj grupeve posaçërisht të ndijshme të qytetarëve.

Formë e posaçme e shkeljes së të drejtave të qytetarëve karakteristike për vitin 2002, është lëshimi nga puna ose kërcnime dhe kryerja e formave të ndryshme të presionit, për arsye të të shprehurit të mendimit të vet, anëtarësi në organizatat joqeveritare, përkatësisht, për shkak të pjesëmarrjes në organizimin ose realizimin e grevës. I këtillë është për shembull rasti me Gjorgji Zajkovin nga Radovishi kundër firmës "SEMKOR" trashëgues juridik i Sh.A. "Buçim" nga Radovishi në arsyetimin e Vendimit për suspendimin nga puna kjo madje edhe haptazi po theksohet: "...Me paraqitjen e vet në mediat, gjatë grevës së firmave-humbëse, i ka bërë dëm firmës...". Kurse Zajkovi për mediat ka thënë: "Ky popull nuk meriton të rrifet! Këtij populli duhet t`i jepet bukë!"; Vala e pakënaqësisë punëtore shprehur përmes grevave, kërkesave për pagimin e rrogave të ngecura, kërkesave për revidimin e privatizimit etj. vazhdoi me intenzitet të pazvogëluar edhe në muajin dhjetor. Ajo që brengos posaçërisht janë kërcnimet për aplikimin e forcës dhe përdorimi i metodave të dhunshme që kulminacionin e arritën në Veles para fabrikës "Kiro Quçuk". Ndërkaq, më 3.12.2002. kur një grup akcionerësh tentoi të bëjë grevë para fabrikës, në drejtim të tyre është shtirë me armë të zjarrtë nga ana e sigurimit të fabrikës, me ç`rast katër veta nga personat që kanë protestuar u lënduan.

Para një presioni të këtillë dhe kërcnimeve të hapta nga ana e strukturave udhëheqëse u gjenden edhe një pjesë e anëtarëve të Komitetit të Helsinkit. Ndaj disa prej anëtarëve është kryer presion i hapur në kuadrin e mjedisit të tyre të punës të dalin nga anëtarësi në Bordin e Komitetit të Helsinkit, ndërsa ndaj të tjerëve ky presion rezultoi në akcion konkret (si për shembull në rastin e Sashko Todorovskit, i punësuar në Ministrinë e punëve të jashtme, kur ministri i

atëherëshëm Slobodan Çashule, tani deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në rradhët e partisë VMRO-DPMNE, haptazi e kundërshtoi të drejtën dhe lirinë e bashkimit dhe e sanksionoi të shprehurit e lirë të mendimit dhe në një procedurë joligjore e shkarkoi nga posti: të ngarkuarin me punë në Misionin e Republikës së Maqedonisë në Strazburg). Procedura kundër këtij vendimi pa arsye po zhagitet, me çka mbështetet mundësia për kryerjen e llojit të këtyllë të presioneve edhe në të ardhmen.

**Komiteti i Helsinkit është i shqetësuar për shkak të varfërimit të mëtutjeshëm të popullësisë, pamundësisë faktike që të praktikohet e drejta e punës dhe për shkak të dhunës dhe kërcënimit me dhunë si mënyra të zgjidhjes së pakënaqësisë së manifestuar të qytetarëve. Mungesa e kushteve elementare për jetë, pasiguria dhe pambrojtësia sociale si dhe pauperizimi i popullësisë, po bëhen një nga pengesat kryesore në praktikimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Mungesa e një akcioni përkatës nga ana e shtetit në drejtim të zgjidhjes të kësaj gjendjeje, si dhe paralajmërimi për restriksione në fushën e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, mund të paraqesin bazë për turbullira me përmasa më të mëdha dhe ngecje e zhvillimit të demokracisë dhe strukturave demokratike.**

### ***9. Diskriminimi në bazë të gjinisë/origjinës***

Theksi i shkeljes së të drejtave të gruas në vitin 2002 vehtet në dhunën ndaj gruas. Të dhënat statistikore dhe hulumtimet e organizatave joqeveritare tregojnë se 8 nga 10 gra në shtet janë viktima të dhunës fizike. Në rastet e dhunës fizike ose psikologjike vetëm 20% nga rastet paraqiten ndërsa intervenim të policisë ka vetëm në 8% nga rastet e paraqitura. Mënyra më e vështirë e shkeljes së të drejtave të grave në Republikën e Maqedonisë ende është dhuna familjare. Shqetëson e dhëna se çdo e 4-ta grua në Maqedoni është viktimë e dhunës familjare. Situata në këtë sferë është edhe më alarmante edhe me vet aktin që ky lloj i veprave penale për shkak të rregullativës jopërkatëse dhe jo të plotë ligjore nuk sanksionohet në mënyrë përkatëse. Kryerësit s`mund të ndjeken përmes detyrimit zyrtar, kurse procedurat penale për veprat që hyjnë në nocionin dhunë familjare mund të nxiten vetëm përmes padisë private. Së këndejmi, viktimat e dhunës familjare në një numër të madh nuk janë në gjendje të nxisin as padi penale, sepse shpeshëherë frikësohen nga dhuna plotësuese sikurse në rrethin e familjes, ashtu edhe në suazat e rrethinës nga e cila do të shënohen. Evidenca për dhunë seksuale në suazat e familjes nuk ekziston, mirëpo në praktikë ekziston i ashtuquajturin numër i zi, sepse këto viktima s`duan të flasin për këtë. Konsiderohet se rritja e rasteve të incestit, kryesisht shprehur ndaj fëmijëve femëror, sqarohet me faktin se si rezultat i situatave dhe rrethanave të ndryshme, (në këtë rast, konflikti ushtarak) njerëzit reagojnë në mënyrë të çuditshme dhe të pazakonshme.

Shkelje tjera të të drejtave të grave në këtë periudhë janë shkeljet që dalin nga martesat dhe familja, ku nga të gjitha martesat e lidhura midis të miturëve në Republikë në vitin 2002, në 90% nga ata i mituri është fëmija femëror. Me të ashtuquajturin votim familjar, ndërkaq, kryesisht në rastet ku gruaja është analfabete, shkelet e drejta e votës në përgjithësi dhe sekretin e votimit. Mund lirisht të konstatohet se në dy vitet e kaluara shteti s`ka bërë asgjë në lidhje me kërkesat për ndryshimin e ligjeve të paraqitura nga Organizatat joqeveritare dhe shoqatat humanitare që punojnë në përmirësimin e të drejtave femërore në

Republikën e Maqedonisë. Në bazë të akcioneve dhe hulumtimeve të këtyre organizatave dhe shoqatave është paraqitur propozimi për reforma të ligjeve edhe atë të Kodeksit penal, Ligjit për të drejtën penale, Ligji për obligacione, Ligji për familjen, Ligji për trashëgimi, të gjitha këto të ndërlidhura me dhunën familjare, shkeljen e të drejtave nga marrëdhëniet e punës, që kanë të bëjnë me shqetësimin seksual gjatë punësimit dhe në vet vendin e punës.

Akcioni i organizatave joqeveritare për arritjen e 30% të pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë është bishtëruar me vendosjen e grave-kandidate në vendet e fundit të listave kandiduese të partive dhe deplasimi i tyre faktit.

**Në disa vitet e fundit është rritur veprimi i sektorit joqeveritar në fushën e arritjes së barazisë së gjinive. Si rezultat i këtij veprimi është rritur pjesëmarrja e grave në politikë dhe në qeverisje. Mirëpo, shumë pak ose kurrfarë levizjeje s`është bërë në drejtim të arritjes së barazisë së gjinive në familje dhe në mikro-mjediset e jetës dhe punës. Në planin individual gruaja u është ekspozuar dhunës, maltremit seksual, kurse presioni social nuk i mundëson kundërshtimin aktiv në secilin rast konkret. Në hulumtimet e bëra me fëmijë të moshës 9-10 vjeçare, evidente është situata kur vajzat e vogla vlerësohen më ulët dhe s`kanë besim në vet-vehten në krahasim me djelmoshat.**

#### ***10. Persona me sfida të posaçme***

Vitin e kaluar është rritur aktiviteti i shoqatave joqeveritare të personave me sfida të posaçme (janë organizuar manifestime, fushata dhe aktivitete konkrete për përfshirje më të lehtë të këtyre personave në jetën e përditshme). Mirëpo, shteti nuk u përfshi as drejtëpërdrejtë e as në mënyrë indirekte në këto aktivitete dhe s`tregoi vetëdije për obligimet e veta në mbrojtjen e të drejtave të këtij grupi qytetarësh. Të gjitha aktivitetet mbesin në nivelin e veprimit të sektorit joqeveritar, që e pamundëson parashtrimin dhe zgjidhjen e vërtetë të problemit. Kjo veçanërisht bie në sy nëse kihet parasysh se është përgatitur dhe miratuar Strategjia kombëtare për barazimin e të drejtave të personave me hendikep në Republikën e Maqedonisë, në suazat e së cilës është formuar edhe Trupi i përhershëm koordinativ kombëtar. Përkundrazi, në periudhën e fundit, në vend të avancimit në lidhje me këto çështje, ekziston një degradacion serioz i ndihmuar institucionalisht, sikurse në planin normativ ashtu edhe në atë faktik. Me këtë është bërë një hapërim serioz – në vend kah integrimi i këtyre personave – kah segregacioni i tyre social. Restriktiviteti institucional u manifestua në një sërë planesh, duke filluar nga arësimimi dhe punësimi, përmes mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, e deri te politika e transportit, duke përfshirë edhe çështjen për lirimet doganore të automjeteve për personat me sfida të posaçme. Me të gjitha këto “veprime të vogla”, e që sistematikisht ndërtohen në aktet nënligjore dedikimi i të cilëve është të mundësojnë realizimin e ligjeve në jetën praktike, vihet deri te rrezultati i përgjithshëm kur personat me sfida të posaçme janë zhvendosur nga aktivitetet shoqërore dhe jeta e përgjithshme, sikurse nga aspekti financiar, ashtu edhe në sferën e vendosjes dhe gëzuarjen e barabartë të të drejtave dhe lirive esenciale. S`ka indikacione se po përgatitet një kurs i ri më i ndryshëm dhe strategji e ministrit të ri për punë dhe politikë sociale ose të ministrit për financa. Këtë e vërteton edhe e dhëna se është refuzuar propozimi

për shfrytëzimin e regjistrimit të realizuar në nëntor të vitit 2002 për regjistrimin edhe të personave me sfida të posaçme (edhe përkundër asaj se kjo mund të kuptohet si pjesë e angazhimeve të paraqitura në Rregulloren për vlerësimin e nevojave specifike të personave me pengesa në zhvillimin fizik ose psikik, të sjellur nga ana e Ministrisë për punë në vitin 2000).



Personat me sfida të posaçme nuk arritën sukses në perpjekjet e tyre të fusin grafë të posaçme në materialet e regjistrimit me qëllim të caktohet përqindja e qytetarëve të këtyre. Mungesa e njohurive elementare për përqindjen dhe llojet e hendikepit, është në favor të joaktivitetit të shtetit në lidhje me zgjidhjen e problemeve specifike me të cilët ballafaqohen këto qytetarë dhe në lidhje me përfshirjen e tyre në të gjitha segmentet e jetës shoqërore. Mungesa e personave me sfida të posaçme nga pushteti dhe funksionet në shtet, por edhe prania e tyre marginale në jetën e përditshme dhe në përgjithësi në opinion, kontribuojnë për marginalizimin e përhershëm dhe të tërësishëm të votës së këtyre qytetarëve dhe të mundësisë të kënaqen nevojat dhe interesat e tyre esenciale.

### **11. Të drejtat e pakicave seksuale**

Për herë të parë në shtet është regjistruar një shoqëri e cila në programin e vet e parashikon promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësisë LGBT (Qendra për të drejtat qytetare dhe njerëzore). Ky është vetëm hapi i parë në procesin e promovimit dhe mbrojtjes të të drejtave seksuale si të drejta të njeriut. Sipas rezultateve të hulumtimit të bërë nga ana e Komitetit të Helsinkit, Qendra për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konflikteve dhe Qendra për të drejtat qytetare dhe të njeriut, raporti i opinionit ndaj homoseksualitetit në



masë të madhe është negative. Homoseksualiteti trajtohet si sëmundje, homoseksualistët s`guxojnë publikisht ta manifestojnë përcaktimin seksual sepse egziston kërcnimi i qartë me diskriminim (në fushën sociale dhe të punës) dhe janë të getoizuar dhe të përkufizuar në lirinë e lëvizjes. Mund të pritet valë e fuqishme diskriminuese në momentin e manifestimit public të orientimit homoseksual, kurse nuk ekzistojnë indikacione se shteti është i gatshëm të reagon përkatësisht në një situatë të këtillë.

Veçanërisht shqetëson e dhëna se edhe në tekstet e reja edukative, por edhe profesionale, homoseksualiteti trajtohet si sëmundje psikike, respektivisht, si cilësi e çuditëshme (“hendikep mental”) që duhet të shërohet (Lubisha Novotni, Psikijatria gjyqësore, SGB “Studentski zbor”, Shkup, 1998, f. 196-197 dhe 205).

## **12. Mbrojtja e ambientit të njeriut**

Viti 2002 karakterizohet me ngritjen e vetëdijes për problemet ekologjike, mirëpo jo edhe me zgjidhje konkrete të problemeve të evidentuara. Në Komitetin e Helsinkit janë regjistruar më shumë raste të rrezikimit të të drejtës së ambientit të shëndoshë (ndotja e lumit Radika dhe pasoja tjera nga puna e firmës austriake Sh.A. KNAUF; ndotja nga shkretorja në Veles; mulliri i minierës për jometale “Ograzhden”) të cilët ende s`kanë trajtim përkatës nga ana e shtetit dhe një përfundim përkatës gjyqësor.

Nën patronatin e Fondit për ambientin, më 27 qershor në Veles u organizua një konferencë ndërkombëtare për mbrojtjen e ambientit në të cilën sërisht u aktualizua gjendja tragjike e ambientit në këtë qytet. Pritej që në këtë konferencë të zbardhen rezultatet nga monitoringu që Laboratoriumi qëndror i Ministrisë për ambientin i realizoi në shkretoren e KMK “Zletovo”, por nuk erdhi deri te kjo. Kjo s`është hera e parë që të murkulohet katastrofa ekologjike në Veles dhe rrethinën. Siç dihet, para katër vjet, u emitua një film dokumentar me titull “KML – Koncentrimi maksimal i lejuar”, i cili paraqiti njohuri të tmershme. Për shkak të reagimeve të shumta, u hoq nga emitimi. Por, u lajmërua Shoqata e prindërve për përkujdesje për gjenerata të shëndosha nga Velesi, e cila i prezantoi njohuritë e veta për rastet e rënda të sëmundjeve te fëmijët. Shoqata dëshmon se edhe pse shërbimet mjekësore sikurse edhe të gjithë organet kompetente janë të vetëdijshme se deformitetet janë pasojë e ndotjes nga shkretorja ende s`janë ndërmarr kurrfarë masa. Ata kërkojnë që shteti ta merr përgjegjësinë për “gjenocidin ekologjik” në Veles. Në deklaratat e fundit dhënë për gazetën “Dnevnik”, drejtori i Entit republikan për mbrojtje shëndetësore – Bllagoja Aleksoski, deklaroi se s`ka kurrfarë të dhëna se shkretorja ndikon dëmshëm mbi shëndetin e qytetarëve dhe konsideron se çfarëdo proekti në suazat e të cilit do të bëheshte një analizë në detaje për këto ndikime, duhet të fillon si inicjativë e “faktorëve vendimtar” – pa marrë parasysht kush janë ata.

E drejta e ambientit të shëndoshë në muajin qershor i`u prish edhe banorëve të lagjes Devijacija në Strumicë. Mulliri i minierës për jometale “Ograzhden” në fillimin e këtij muaji filloi të emitojë në ajër “pluhur helmues”. Ekspertët nga Fakulteti xehtarogjeologjik në Shtip paralajmërojnë se afërsia e fabrikës e cila prodhon silikate dhe thithja shumëvjeçare e pluhurit nga felsepadi mund ta shkakton sëmundjen e rëndë të mushëkrive të bardha, silokozën. Prandaj, banorët e frikësuar u dërguan një peticion mediave, sepse dyshojnë se organet kompetente do t`i mbrojnë, sepse udhëheqësit e “Ograzhdenit” janë “politikanë me influencë” Ata u deklaruan mediave se deri më tani disa herë kanë

biseduar me drejtorin e minierës, me ç'rast ai gjithëmonë kishte sjellje nënçmuese dhe e ka mohuar seriozitetin e këtij fenomeni.

Standardin ISO 14001 (për menaxhim me qëllim të mbrojtjes së ambientit) në Republikën e Maqedonisë e kanë futur vetëm dy frima: Alkaloidi (në dy reparte) dhe Kontioplast në Gjevgjeli.

**Komiteti i Helsinkit përkujton se vitin e kaluar opinioni kishte rastin të njihet me gjendjet alarmante në planin e ambientit në Veles, Manastir etj. Për fat të keq, mbisundoi i ashtuquajhuri “interesi ekonomik”. Mirëpo, bëhet fjalë për mashtrim pas të cilit gjendet, për shoqëritë demokratike e palejueshme zgjedhja midis dy opsioneve negative: të humbet burimi i ekzistencës për shumë familje anëtare e të cilave punojnë në fabrikat-ndotës ekologjik ose të tolerohet, por bashkë me të gjithë të tjerët në qytet, shkalla e këtyre ndotjes që ndikon drejtëpërdrejt në shëndetin jo vetëm të të rinjëve por të të gjitha gjeneratave. Së këndejmi, jemi të bindur fuqimisht se dy ministritë kompetente, për ambientin dhe ajo e ekonomisë, janë fajtorë të drejtëpërdrejtë për zgjedhje të këtyre negative të qytetarëve edhe të Velesit edhe të Strumicës dhe se janë më tepër se përgjegjës edhe atë me urgjentisht t'a marrin përgjegjësinë dhe të ofrojnë zgjedhje midis dy opsioneve positive.**

### **13. Regjistrimi**

Gjatë muajit Nëntor u realizua regjistrimi i rregullt i qytetarëve, amvisërive dhe banesave nën mbikqyrjen ndërkombëtare nga 50 ekspertë nga 26 vende. Sipas deklaratave të Komisionit shtetëror të regjistrimit dhe Entit statistikor, Regjistrimi ishte në një nivel të dëshiruar, kurse vëzhguesit ndërkombëtar në vlersimin e tyre preliminar e vlerësuan pozitivisht tërësinë e këtij operacioni voluminoz statistikor. Sidoqoftë, informacionet nga tereni japin një fotografi tjetër.

Mediat informuan gjërësisht për një sërë parregullësi: regjistrimi me laps, dorëzimi me vonesë i autorizimeve të regjistruesëve në Dibër dhe rrethinë, familje të caktuara në Kavadarë kanë refuzuar të regjistrohen për shkak të besimit se gjatë pranimit të kandidatëve për regjistrues është bërë seleksionimi mbi baza partiake (në favor të partisë VMRO-DPMNE), refuzime të këtyre, por me motivacione tjera kishte edhe në Shkup, manipulime regjistruese me përkatësinë etnike të Maqedonasëve-musliman në Dibër, në Qendrën e Zhupës, në rrethin e Strugës dhe të Ohrit (ata u regjistruan si Shqipëtarë ose Turq) etj. Vështirësi plotësuese në kuptimin e verifikimit të rezultateve të fituara është refuzimi i disa fshatrave të Pollogut të bëhet kontrollimi pas regjistrimit. Mediat në gjuhën shqipe, nga ana tjetër, bënë në dije një seri rastesh kur është paraqitur mungesa e regjistruesëve të kombësisë shqipëtare. Veçohen rastet në Shuto Orizarë ku deri më 12 nëntor, regjistrimi, kinse, ende s'kishte filluar për shkak të mungesës së këtyre, ose në Çair ku për të njëjtin shkak rajonin e kanë marr regjistrues-Maqedonas, kurse në kërkesën e Shqipëtarëve etnik të regjistrohen në gjuhën e tyre amtare – kanë marr përgjegje ironike. Vëzhguesit e Komitetit të Helsinkit sinjalizuan qysh në kohën e selektimit të regjistruesëve se ka një numër parregullësi në këtë procedure, si dhe se të dhënat nga evidenca e katastarit shpeshëherë janë ose të vjetruara ose të paazhuruara, e madje edhe krejtësisht të pasakta. Dëshmi për këtë ishin edhe disa raste në rrethinën e Shkupit ku rrugë të tëra, madje edhe bashkësi vendore ishin të “kapërcyera”. Komiteti i Helsinkit, nga ana e bashkësisë rome u njoh me vlersimet e tyre së një numër i madh familjesh

rome në më shumë qytete në Maqedoni nuk janë përfshirë nga regjistrimi. Në rrethinën e Velesit s`është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesit të komunitetit rom në Komisionin regjistruar nga ky rajon regjistruar, e që është në kundërshtim të drejtëpërdrejtë me nenin 29 paragrafi 4 nga Ligji për regjistrim. Si rezultat i kësaj , s`ka mundur në mënyrë përkatëse të ndikohet mbi sistemimin e regjistruarëve Romë në qarqet regjistruarë, me çka erdhi deri te mungesa e këtij grupi të regjistruarëve. Problem i posaçëm te Romët është shkalla e lartë e analfabetëve, që është në lidhje të ngushtë me problemin rreth legjitimitit të popullësisë për shkak të mungesës së dokumentave valide personale. Regjistruarët u ballafaquan me një situatë absurde, pamundësia e zgjidhjes së këtyre problemeve për shkak të mungesës së të ashtuquajturit “PD-1 formularë”, e të cilët specialisht janë parashikuar të përdoren në rastin e mosposedimit të dokumentave themelore për identifikim personal.

Për bashkësitë vllehe në Veles, Koçan, Vinicë nuk ishte parashikuar pranimit i regjistruarëve Vllehë, kurse në Shkup numri i regjistruarëve të bashkësisë vllehe është simbolik. Pjesa dërmuese e regjistruarëve të pranuar si pjesëtarë të bashkësisë vllehe fare nuk e njihnin gjuhën vllehe.

Aspekt i posaçëm i regjistrimit të popullësisë në Republikën e Maqedonisë (që shumë pak është marr parasysh në regjistrimin më të ri) paraqet karakteri i saj emigracional, respektivisht, mungesa shumëvjeçare e qytetarëve përkatës nga territori i saj (por me relacione evidente të fuqishme familjare dhe tjera).

**Komiteti i Helsinkit s`mundi të bindet se Regjistrimi është përgatitur mirë dhe realizuar përkatsisht edhe përkundër disa shtyerjeve. Prandaj, konsiderojmë se është shumë e rëndësishme periudha e sumimit të rezultateve, kurse me rëndësi kyçe është sinqeriteti i lartë nga ana e Entit për statistikë në kuptimin e vlersimit të qëndrueshëm – a thua rezultatet e fituara janë të përdorshme për një përpunim kredibil. Poashtu, Komiteti i Helsinkit e ftoi Qeverinë që t`a rishqyrton përdorshmërinë e kësaj metode të numrimit të popullësisë dhe t`i hulumton mënyrat tjera që do të mundësonin rezultate më relevante dhe më të përdorshme.**

#### **14. Shërbimi civil i ushtrisë**

Hapërim pozitiv në drejtim të mbrojtjes së lirisë të mendimit dhe besimit është fillimi i implementimit të dispozitave për shërbimin ushtarak civil nga Ligji për mbrojtje. Në Nëntor, Ministria për mbrojtje nxori më shumë vendime për pranimin e kundërshtimit të vetëdijes, përkatësisht për shërbimin civil të afatit ushtarak. Me këtë rast, pranimit s`ka të bëjë vetëm me rastet religjioze, por edhe me personat tek të cilët kundërshtimi i vetëdijes bazohet në bazë të bindjeve personale. Një pjesë e këtyre rasteve zhvilloheshin përmes zyrës të Komitetit të Helsinkit.

Me qëllim të aplikimit praktik të mundësisë për shërbimin ushtarak civil, nevojitet zhvillimi i rregullativës specifike me të cilën do të definohen mënyrat, vendet, kushtet dhe kohëzgjatja e shërbimit të afatit ushtarak jashtë institucioneve të ushtrisë. Veçmas duhet të zgjidhet edhe çështja e kohëzgjatjes të këtij shërbimi, që në këtë moment paraqet një lloj diskriminimi në raport me ato që janë të gatshëm t`a praktikojnë (veçanërisht me rritjen e dallimit në raportin e këtyre dy llojeve të shërbimit të afatit ushtarak).

## **15. Të drejtat e fëmijëve**

Gjatë vitit 2002 të drejtat e fëmijëve u cënuan në mënyrë të kontinuar, nga ana e individëve, nga ana e organeve shtetërore, si dhe nga ana e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Shteti nuk ndër morri masa për pengimin e keqpërdorimit të fëmijëve në qëllime politike, që veçanërisht u manifestua në periudhën parazgjedhore. Fëmijët u shfrytëzuan në mënyrë aktive dhe pasive në funksionin e propagandës partiake dhe u përfshinë drejtëpërdrejt në qërrimin e hesapeve ndërpartiake. Në shumë qytete janë regjistruar rrahje të grupeve të fëmijëve që i kanë bartur shenjat e partive të ndryshme politike. Gjatë periudhës parazgjedhore shumë parti ndanin fanella pa menga, kapuça dhe pjesë tjera të veshjes me shenja partiake dhe i përdornin fëmijët si pano të gjallë të propagandës partiake.

Gjatë vitit 2002 s'është bërë asnjë aktivitet serioz në drejtim të zgjidhjes së problemit me fëmijët nga rruga dhe me keqpërdorimin e punës fëmimore që është në kundërshtim me nenet 29 dhe 32 të Konventës për mbrojtjen e fëmijëve.

Rregullativa restriktive nënligjore nga fusha e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale (zvogëlimi i beneficioneve dhe shkurtimi i listave pozitive me ilaçe dhe ndihmesa tjera), si dhe rënja e standardit, sjellin deri te keqsimi i gjendjes shëndetësore të fëmijëve dhe rianimacioni, respektivisht, fuqizimi i sëmundjeve siç janë: tuberkuloza, verdhëza dhe llojet e ndryshme të diresë. Kjo s'është konfirmuar në lajmrimet zyrtare të institucioneve shëndetësore, por është indikuar nga informacionet e organizatave joqeveritare që punojnë në teren.

Fëmijët në vendet në të cilët u zhvillua konflikti i armatosur ishin ekspozuar në një rrezik të posaçëm për shkak të infrastrukturës së parregulluar në vendet e kthimit, përderisa fëmijët e personave të çvendosur ende jetojnë në kushte krejtësisht jopërkatese që ndikojnë negativisht sikurse në zhvillimin e tyre psikik dhe fizik, ashtu edhe në arsimimin e tyre dhe shansat për shkollimin e mëtutjeshëm.

Gjatë vitit 2002 e drejta e arsimimit të një numri të madh të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë u rrezikua seriozisht (për shkak të kushteve jopërkatese në shkollat – mungesa e lëndëve djegëse, lagështia e objekteve ose shkaqe tjera materialo-teknike; përdorimi i fëmijëve për manifestimin e pakënaqësisë së prindërve nga vendime të caktuara politike ose të tjera të pushtetit të ndërlidhura ose jo me vet procesin arimor; papërgjegjësia e prindërve në plotësimin e obligimeve për dërgimin e fëmijëve në shkollat fillore; pasiguria e hapësirës në ose rreth shkollave). Ministria e arsimit reagonte jopërkatesisht në rastet e dhunës mbi nxënësit (sikurse në gjimnazin Qirili dhe Metodi nga Negotina dhe shkolla fillore Ramizi dhe Hamidi në Shkup).

Nga ana tjetër, për shkak të tensioneve ndëretnike që vazhdojnë në këtë periudhë, fëmijët e vijnë mësimin në kushte jopërkatese, në kushte që s'janë të dedikuara për këtë nivel të mësimit, me numër të kufizuar ose kuadër mësime të jopërkatese (ngjarjet me nxënësit e bashkësisë maqedonase nga Shemshova, nxënësit e bashkësisë shqipëtare nga shkollat e mesme të Kumanovës, nxënësit e bashkësisë shqipëtare nga Zef Lush Marku në Shkup). Gjatë vitit 2002 Ministria e arsimit s'morri asnjë aktivitet në drejtim të përfshirjes së përmbajtjeve dhe metodave të atilla të punës që do të kontribuojnë për një tolerancë më të madhe, respektimin e dallimeve dhe të njohurit e vlerave demokratike të shoqërisë.

Si rezultat i veprimit (dhe mosveprimit) të Ministrisë së arsimit, gjatë vitit 2002 janë organizuar disa demonstrata të nxënësve me parashenja nacionaliste, është bojkotuar mësimi disaherë në më shumë shkolla dhe është krijuar nivel i atillë i mosdurimit në të cilin nevojitet sigurimi policor i objekteve shkollore. Protestat e nxënësve përfundojnë me: sulme mbi qytetarët, kidnapimi i nxënësve nga bashkësia tjetër etnike dhe shkaktimi i lëndimeve të rënda trupore, rrahja e nxënësve nga bashkësia tjetër etnike, kidnapimi i nxënësve, përdorimi i armës dhe vrasje. Vrasja e nxënësit të shkollës së mesme Josifovski shkaktoi protesta solidare të rinjëve të bashkësisë maqedonase në tërë territorin e Maqedonisë. Për fat të keq, në njerën nga këto demonstrata, më 23 tetor në Shkup, ku më shumë se 15.000 nxënës të shkollave të mesme, në pjesën më të madhe, demonstruan në mënyrë të qetë, ndodhën edhe më shumë incidente. Disa demonstrues më ekstrem sulmuan kalues të rastit që u përngjanin si Shqiptar. Bilanci i këtyre incidenteve ishte një Maqedonas-musliman i lënduar më rëndë, dy Shqiptar etnik të lënduar më lehtë dhe një Maqedonas i lënduar më lehtë. Këto ngjarje sërisht fabrikuan njëfarë lloji të “revanshizmit rrugor”, kësaj rradhe, nga ana e nxënësve Shqiptar të shkollave të mesme që përfundoi me rrahjen e shtatë të rinjëve Maqedonas etnik. Të njejtën ditë në orët e mbrëmjes edhe një grup Maqedonas etnik sulmuan një autobus përplotë me Shqiptar etnik. Duke marrë parasysh se dy nga këto incidente kanë ndodhur në autobusët e Sipërmarrjes publike të transportit -Shkup, kjo sipërmarrje që e detyruar të vendos kontrollin e brendshëm në disa prej autobusave të vet në linjat “2” dhe “63”, por edhe përkohësisht ta anuloi linjën “65”, që qarkullon në drejtim të fshatrave Stajkovcë, Haraçinë dhe Straçincë. Përleshjet midis nxënësve të bashkësisë maqedonase dhe shqipëtare vazhduan deri në fund të vitit 2002 me konfliktet në gjimnazin “Niko Nestor” në Strugë, i cili disa ditë ishte i mbyllur për shkak të qetësisë së situatës). Të vetmen zgjidhje që deri tani e ka ofruar Ministria e arsimit është vendosja e paraleleve maqedonase dhe shqipëtare në objekte të ndryshme (që shikuar në mënyrë afatgjat mund të sjell vetëm deri te ndarja e bashkësive).

Në dhjetor të vitit 2002 mbi 300 nxënës (Shqiptar etnik) nga disa shkolla të mesme të Kumanovës manifestuan shenja të sëmundjeve serioze (për çka janë hospitalizuar, kurse një pjesë prej tyre janë transferuar në Klinikën për toksikologji në Spitalin shtetëror në Shkup). Rasti është shfrytëzuar për ndarjen e mëtutjeshme sipas linjës etnike dhe zhvillimi i mosbesimit midis bashkësive etnike. Shumë shpejt pas kësaj ngjarjeje u vendos një bombë para gjimnazit “Goce Delçev”, në të cilin në këtë moment mësojnë vetëm nxënësit e bashkësisë maqedonase, me ç`rast një person e humbi jetën, kurse një vajzë u lëndua më rëndë.

Përkundrejt neneve 37 dhe 40 të Konventës, fëmijët janë objekt i dhunës nga ana e organeve policore (gjatë ndërhyrjes në kafene, respektivisht, gjatë arrestimit), por edhe i shkeljeve më të mëdha të të drejtave të fëmijëve (sikurse në rastin e Fadil Faretit).

Dhuna shtëpiake filloi të bëhet objekt i reagimeve mediale dhe më të gjera të opinionit, mirëpo s`është i dukshëm ndryshimi qenësor në veprimin e strukturave shtetërore në drejtim të pengimit aktiv dhe sanksionimi i këtyre rasteve.

Edhe përkundër ekzistimit të trupit koordinativ kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve s`janë bërë ndryshime në rregullativën ligjore dhe nënligjore në drejtim të implementimit të Konventës për të drejtat e fëmijëve.

As në planin formal e as në atë praktik shteti s`ka bërë përpjekje për implementimin e dispozitave të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Fëmijët janë keqpërdorur, maltretuar dhe shfrytëzuar individualisht dhe kolektivisht. Ministria e arsimit nuk i`u përgjegj detyrës për sigurimin e të drejtës së arsimit të të gjithë fëmijëve në Republikën e Maqedonisë. Tërësisht ose pjesërisht janë privuar nga arsimimi një pjesë e madhe e fëmijëve të bashkësisë rome, fëmijët e të gjitha bashkësive në pjesët që një vit përpara ishin kapluar me konfliktin dhe fëmijët-refugjatë nga Kosova. Dhuna mbi fëmijët praktikohet privatisht dhe publikisht, pa sanksionimin përkatës të kryerësve të kësaj dhune.

### *Konkludim*

Gjendja me të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë në vitin 2002 karakterizohet me ngritjen e vetëdijes së qytetarëve për të drejtat e tyre, por edhe josenzibiliteti për të drejtat e të tjerëve dhe mungesa absolute e mekanizmave juridike dhe administrative për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Strukturat shtetërore jo vetëm që nuk i promovojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, por paraqiten në rolin e kërcnuesit dhe shkelësit më të madh të këtyre drejtave. Mosbesimin ndaj sistemit juridik qytetarët e manifestojnë me marrjen e “të drejtës” në duar të veta, dhe me greva dhe demonstrata të zgjata (që po bëhet model i veprimit edhe i gjeneratave më të reja). Qeveria e re filloi guximshëm me paralajmërimin për respektimin dhe aplikimin e të drejtës dhe tani më po ndërmerr aktivitete konkrete në këtë drejtim. Ajo që brengos është fakti se: procedurat e ndërmarra kanë të bëjnë vetëm me përfaqësuesit e strukturave të mëparshme qeveritare, kurse nuk po bëhet rishqyrtimi i lëshimeve dhe veprimeve të caktuara të bëra në kohën e qeverisjes së vet; në procedurat nuk respektohet rregullativa ligjore ose bëhen lëshime më të mëdha ose më të vogla në procedurat; para kryerjes së ndryshimeve nuk precizohen mekanizmat dhe kriteret e realizimit të procedurave.

Shqetëson edhe e dhëna se vazhdon të rritet pasiguria e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë për jetën e tyre, për pronën dhe për ardhmërinë e tyre.